

# RAPORTI VJETOR 2020

---

*Prioritetet e Institucionit për vitin 2021*



AUTORITETI I  
KONKURRENCËS

<b>HYRJA.....</b>	<b>3</b>
<b>ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2020 .....</b>	<b>3</b>
<b>FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS .....</b>	<b>5</b>
<b>PJESA E PARË.....</b>	<b>7</b>
<b>DREJTIMET KRESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2020 .....</b>	<b>7</b>
1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë .....	7
1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti gjatë vitit 2020 .....	20
<b>PJESA E DYTË.....</b>	<b>21</b>
<b>ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS.....</b>	<b>21</b>
2.1 Tregjet e monitoruara .....	21
2.2 Kontrolli i përqendrimeve .....	28
2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese .....	33
2.4 Tregjet prodhuese.....	40
2.5 Hetime të përgjithshme .....	43
<b>PJESA E TRETË .....</b>	<b>46</b>
<b>AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE .....</b>	<b>46</b>
<b>PJESA E KATËRT .....</b>	<b>48</b>
<b>ROLI I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURRENCËS.....</b>	<b>48</b>
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative .....	48
4.2 Advokacia e Konkurrencës .....	49
<b>PJESA E PESTË .....</b>	<b>53</b>
<b>INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>53</b>
5.1 Kontributi në kuadrin e integritimit evropian .....	53
5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	53
<b>PJESA E GJASHTË .....</b>	<b>56</b>
<b>ORGANIZIMI I AUTORITETIT .....</b>	<b>56</b>
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës .....	56
6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2020.....	56
6.3 Të ardhurat e realizuara.....	57
6.4 Rekrutimet .....	58
<b>PJESA E SHTATË.....</b>	<b>59</b>
<b>PRIORITETET E AK PËR VITIN 2021 .....</b>	<b>59</b>
7.1 Prioritetet e AK për vitin 2021 .....	59
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE.....	59
<b>ANEKSE .....</b>	<b>61</b>
<b>VENDIMET E AK 2020 .....</b>	<b>61</b>
<b>ÇËSHTJE TË MBARTURA PËR GJYKIM NË VITIN 2020 .....</b>	<b>65</b>
<b>VIZIONI 3-VJEÇAR I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS .....</b>	<b>69</b>

## LISTË SHKURTIMESH

<b>AK</b>	Autoriteti i Konkurrencës
<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>AMF</b>	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>ERRU</b>	Enti Rregullator i Ujit
<b>FNT</b>	Fuqi të ndjeshme në treg
<b>FSDKSH</b>	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
<b>FSHF</b>	Federata Shqiptare e Futbollit
<b>GLN</b>	Gazi i Lëngshëm i Naftës
<b>IAL</b>	Institucionet e Arsimit të Lartë
<b>ICN</b>	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para-Zgjerimit i BE
<b>IDP</b>	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informimit publik
<b>KE</b>	Komisioni Europian
<b>KESH</b>	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
<b>Ligji nr. 9121/2003</b>	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>OECD-GVH/RCC</b>	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik për Evropën Juglindore
<b>OFNT</b>	Operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg
<b>PKIE</b>	Plani Kombëtar për Integrimin Europian
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SFJB</b>	Shoqëri Financiare Jo-Bankë
<b>TFEU</b>	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
<b>TIA</b>	Tirana International Airport
<b>UK</b>	Ujësjellës Kanalizime
<b>UNCTAD</b>	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
<b>VKK</b>	Vendime Komisioni i Konkurrencës

## HYRJA

### ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2020

Viti 2020 u karakterizua nga një ngadalësim i ekonomisë botërore si pasojë e pandemisë së krijuar nga COVID-19. Në rrafshin ndërkombëtar, aktiviteti ekonomik botëror, pas një tkurrjeje të fortë ekonomike në gjysmën e parë të vitit, ka shfaqur shenja përmirësimi në tremujorin e tretë, kohë që përkon me heqjen e masave shtrënguese, të ndërmarra nga shumica e vendeve për frenimin e përhapjes së pandemisë, e cila ka sjellë një gjallërim të konsumit, tregtisë dhe prodhimit industrial.<sup>1</sup>

Edhe në rrafshin kombëtar, ekonomia është goditur në gjithë komponentët e saj, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, duke regjistruar tkurrjen më të fortë të dy dekadave të fundit. Sipas të dhënave zyrtare, si reflektim i masave kufizuese, prodhimi i brendshëm bruto, në tremujorin e dytë u ul me 10.2%, ndërkohë që tregu i punës gjatë 6 mujorit të parë humbi rreth 50 mijë vende pune.<sup>2</sup>

Inflacioni është luhatur në vlera të ngjashme poshtë nivelit 2%, duke reflektuar presionet e ulëta inflacioniste si pasqyrim i kërkesës anemike të gjeneruar nga ekonomia e brendshme dhe ajo e huaj. Politika fiskale ka shënuar një trajektore lehtësuese gjatë vitit 2020. Ajo është orientuar drejt amortizimit të efekteve të shkaktuara nga pandemia, si dhe projekteve rindërtuese për eliminimin e pasojave të tërmetit. Sipas të dhënave të BSH, borxhi publik në gjashtë muajt e parë të vitit 2020 është zgjeruar me 12,7 pikë përqindjeje, duke e çuar atë në nivelin 79% të prodhimit të brendshëm bruto.

Kjo situatë ekonomike është reflektuar edhe në përkeqësimin e klimës së biznesit vendas. Sipas vërtetimit të realizuar nga Banka Botërore<sup>3</sup> në lidhje me ndikimin e pandemisë COVID-19 në sektorin privat në Shqipëri: *analiza aktuale dhe e ardhmja*, konkludohet se: në 71% të ndërmarrjeve ka patur një rënie të madhe të kërkesës dhe shitjeve të realizuara, e cila i ka detyruar ndërmarrjet të ulin kostot dhe punësimin; 58 % e ndërmarrjeve janë gjendur përballë një stresi financiar të menjëhershëm shoqëruar me vonesa në pagesa për furnitorët e tyre; 77% e ndërmarrjeve në përgjigje të krizës përshtatën operacionet e tyre duke përdorur mjetet e teknologjisë dixhitale, realizimin e aktivitetit ekonomik online nëpërmjet internetit dhe punës në distancë, e cila ka qenë relativisht e vështirë.

Viti 2020, sipas studimit të OECD “*COVID-19: sfidat menaxheriale dhe rreziqet për autoritetet e konkurrencës*”<sup>4</sup>, sollti edhe sfida të përbashkëta për autoritetet e konkurrencës si: vonesa në proceset gjyqësore për çështjet në gjykata; pengesa në realizimin e inspektimeve në mjediset fizike të ndërmarrjeve për evidentimin e marrëveshjeve kartel dhe abuzimit me pozitën

<sup>1</sup>[https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime\\_Periodike/Raporti\\_i\\_Politikes\\_Monetare/Raporti\\_Tremujor\\_i\\_Politikes\\_Monetare\\_2020\\_IV.html](https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_i_Politikes_Monetare/Raporti_Tremujor_i_Politikes_Monetare_2020_IV.html)

<sup>2</sup> [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

<sup>3</sup> <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/covid-19-impact-albanias-private-sector-taking-stock-looking-ahead>

<sup>4</sup> <https://www.oecd.org/competition/COVID-19-managing-operational-challenges-and-enforcement-risks-for-competition-authorities.pdf>

dominuuese; vonesa gjatë afateve të procedurave hetimore dhe njoftimit të përqendrimeve; mosrealizimi i seancave dëgjimore dhe marrjes së vendimeve; problematika gjatë procesit të punës në distancë duke përdorur mjete elektronike, të cilat rrisin rrezikun e gabimeve procedurale; vendosja e gjobave efektive për shkeljet antikonkurruese, të cilat mund të jenë më të vështira për t'u argumentuar kur ndërmarrjet janë në gjendje të vështirë financiare.

Pavarësisht sfidave me të cilat na përballi situata ekonomike globale dhe kombëtare gjatë vitit 2020, Autoriteti i Konkurrencës, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës, ka vazhduar realizimin e monitorimeve, inspektimeve, vlerësimeve ligjore, për tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, duke i shoqëruar ato me vendimmarrjen përkatëse të Komisionit të Konkurrencës.

## **FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Viti 2020 do të kujtohet për një kohë shumë të gjatë, si një nga periudhat më të vështira me të cilat është përballur njerëzimi këto 70 vitet e fundit. Shpërthimi i pandemisë së virusit COVID-19 në fillim të vitit të shkuar, krijoi pasiguri dhe frikë të madhe anembanë botës. Në përgjigje ndaj saj, autoritetet qeverisëse, në shumicë dërrmuese si kundërpërgjigje, adoptuan masa që në thelbin e tyre kishin izolimin dhe distancimin social të popullatës.

Realiteti mbarë botëror, në dimensionin politik, ekonomik dhe social u karakterizua nga paqartësi të mëdha përgjatë gjithë vitit, ndërkohë që përveç humbjeve të jetës, fatura e pandemisë ishte shumë e lartë, veçanërisht për sa i takon aktivitetit ekonomik dhe financiar në rang global, por jo vetëm. Edhe ekonomia jonë përjetoi pasojat e pandemisë, duke manifestuar rënie të prodhimit, humbje të vendeve të punës dhe rritje të borxhit publik.

Në këtë ambient kaq sfidues ka marrë jetë dhe veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë vitit të kaluar. Ambienti sfidues imponon nevojën për reagime sfiduese, të mbështetura gjerësisht në parimet bazë të teorisë së konkurrencës dhe në praktikat më të mira të reagimit në kushte krize. Nga ky këndvështrim, veprimtaria jonë ndërmjet të tjerash ka synuar në hetimin pa ndërprerje të tregjeve të ndryshme, të cilat vlerësohen me potencial të lartë spekulimi për shkak të pandemisë.

Në vazhdim, po ndalem shkurtimisht me aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2020. Prioritet kryesor i punës sonë ka qenë ndjekja në vazhdimësi dhe plotësimi i të gjitha rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019”. Përfitoj nga rasti të njoftoj Kuvendin e Shqipërisë se të gjitha detyrat e vëna nga Kuvendi, janë trajtuar rast pas rasti dhe me përgjegjshmëri. Në përfundim të vitit 2020, konstatojmë se të gjitha rekomandimet janë adresuar në mënyrë shteruese, duke i përkthyer ato në një sërë vendimesh detyruese për një mori entesh, operatorësh dhe institucionesh të përfshira.

Në qendër të veprimtarisë së Autoritetit ka qenë monitorimi i tregjeve. Gjatë vitit 2020 janë realizuar 19 monitorime, nga të cilat 6 buronin nga vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës gjatë vitit 2019. Fokusi i monitorimeve ka qenë qëmtimi i tregut për një grup produktesh dhe shërbimesh që lidhen drejtpërdrejt me konsumatorët. Kontrolli i përqendrimeve është materializuar nëpërmjet vlerësimit të 27 rasteve, nga të cilat Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 19 prej tyre, ndërkohë që 8 raste nuk kanë përmbushur kriteret për t’u autorizuar nga KK. Nga autorizimi i përqendrimeve, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën 12,410,000 lekë.

Hetimi i marrëveshjeve të ndaluara dhe i abuzimit me pozitën dominuese, ka zënë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e Autoritetit. Shërbimet bankare, produkte specifike të tregut të sigurimeve, shërbimet me pakicë të telefonisë celulare, tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit, si dhe tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, kanë qenë në qendër të hetimit për marrëveshjet e ndaluara.

Kujdes është treguar edhe në lidhje me identifikimin e abuzimit me pozitën dominuese. Në qendër të këtij hetimi ka qenë tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit; tregu i ngarkim – shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të gazit të lëngshëm; tregu i ngarkim – shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve; tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto; si dhe tregu i shërbimit të ngarkim – shkarkimit të anijeve me kontenierë në portin e Durrësit.

I gjithë ky aktivitet i dendur ka prodhuar një vendimmarrje të konsiderueshme të natyrës detyruese, por edhe penalizuese të Komisionit të Konkurrencës. Nga vendimet e marra gjatë vitit 2020 janë dhënë 11 vendime penalizuese, me një shumë në masën 20,038,640 lekë. Një pjesë e vendimmarrjes tonë nga disa subjekte është ankimuar në gjykatë, procese të cilat kanë njohur një ecuri të mbarë, ku AK ka fituar gjykimet në gjykatën administrative të shkallës së parë, ndërkohë që një pjesë tjetër është ende për t'u gjykuar në shkallët e tjera të gjyqësorit.

Autoriteti i Konkurrencës ka treguar kujdes të veçantë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Edhe pse në rrethana jo normale, Autoriteti mundi të përmbyllte me sukses Projektin e Binjakëzimit me Autoritetin Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën. Në përfundim të tij u bë i mundur, hartimi i propozimeve ligjore konkrete, në lidhje me disa shtesa dhe ndryshime që duhet të bëhen në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me qëllim përafrimin e tij më të plotë me standardet dhe praktikën e vendeve anëtare të BE, në fushën e konkurrencës.

Viti që mbyllëm ishte sfidues. Po kaq sfidues ka filluar dhe viti 2021. E ardhmja e afërt dhe ajo pak më e largët karakterizohet nga pasiguri të shumta. Rreziqet më së shumti lidhen me ecurinë e pandemisë, kohëzgjatjen e saj dhe të protokolleve të kujdesit shëndetësor, ndërkohë që në një rrafsh më afatgjatë, rreziqet mund të jenë të natyrës strukturore. Përtej kësaj prognoze, Autoriteti do të vazhdojë të monitorojë në një kënd 360 gradë ecurinë e tregjeve në Shqipëri, duke bërë kujdes maksimal për të diktuar dhe për të ndërhyrë, sa herë konstaton shtrembërim të konkurrencës apo abuzime me pozitë dominuese në treg.

Autoriteti i Konkurrencës është plotësisht i ndërgjegjshëm për vështirësitë objektive që po përballon vendi në këtë kohe pandemie, por përfitoj nga rasti të siguroj Kuvendin dhe publikun e gjerë, se me përgjegjshmëri të plotë do të vazhdojmë me maturi dhe këmbëngulje rrugën tonë, në përmbushjen e mandatit ligjor të Autoritetit.

Ju Faleminderit,

**Prof. Dr. Juliana Latifi**

## PJESA E PARË

### DREJTIMET KRESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2020

#### 1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019”, nr. 154/5, datë 09.06.2020, AK ka realizuar veprimtarinë e tij në këto drejtime:

*Të mbajë në monitorim dy përqendrimet e autorizuara gjatë vitit 2019, në dy nga tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorëve, si: tregu i telefonisë celulare dhe tregu financiar, me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sillte në treg ndryshimi i kontrollit të shoqërive respektive.*

*AK ka përmbushur këto rekomandime të dhënë sipas Rezolutës.*

- KK, me vendimin nr. 610, datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”, vendosi:
  1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD.
  2. Mbajtjen në monitorim për një periudhë 1 (një)-vjeçare nga marrja e këtij vendimi, të veprimtarisë së shoqërisë Telekom Albania SHA.
  3. Detyrimin e shoqërisë Telekom Albania SHA, të njoftojë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës të gjitha ndryshimet e kryera në paketat standarde, oferta promovionale, tarifa standarde që do të hedhë në treg, gjatë periudhës së monitorimit.

Në kuadër të monitorimit, në zbatim të pikave 2 dhe 3 të vendimit KK nr. 610, datë 10.04.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”, shoqëria Telekom Albania SHA ka njoftuar AK për ndryshimet në paketat standarde gjatë periudhës kohore 10.06.2019 - 22.06.2020, duke përmbushur detyrimin ligjor.

- KK, me vendimin nr. 580, datë 17.01.2019, “Mbi përfutimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE”, vendosi:
  1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje, me kushtet dhe detyrimet e mëposhtme:
    - a. Të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
    - b. Të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk



- kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë;
- c. Të mos ushtrojë veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të;
  - d. Transaksioni të sigurojë eficiencë ekonomike dhe të japë siguri mbi qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punës, të stafit ekzistues të Tirana Bank SHA.
2. T'i rekomandojë Bankës së Shqipërisë që:
    - a. Për çështje të stabilitetit financiar, të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK, që zotërojnë pozitë dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë, duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre.
    - b. Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës çdo ndryshim në strukturën e shoqërive të monitoruara, ku mund të krijohet apo forcohet pozita dominuese në treg.
  3. Autorizimi i miratuar me këtë vendim do të hyjë në fuqi pas miratimit të transaksionit nga Banka e Shqipërisë.
  4. Monitorimin e sjelljes së shoqërisë Tirana Bank SHA, për një periudhë 1 (një)-vjeçare nga data e marrjes së këtij vendimi.

AK ka realizuar monitorimin sipas parashikimit të pikës 4 të VKK nr. 580, datë 17.01.2019.

Gjatë periudhës së monitorimit u konstatua se **Tirana Bank SHA** nuk ka aplikuar kushte shtesë apo nuk i ka vendosur shoqëritë e tjera në kushte të pabarabarta konkurrence; nuk u konstatua shtim i komisioneve për të njëjtat shërbime; nuk ka ushtruar veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me bankën dhe numri i punonjësve aktualë të bankës është në rritje, krahasuar më periudhën para përqendrimit.

Në lidhje me zbatimin e **rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë** u konstatua se BSH, pas miratimit të transferimit të pronësisë së Tirana Bank SHA, miratuar më vendimin nr. 17, datë 06.02.2019, nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, dhe në zbatim të nenit 4, pika 9.2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në RSH", ka parashikuar një regjim specifik mbikëqyrës për Tirana Bank SHA, i cili ndiqet dhe monitorohet vazhdimisht. Sipas këtij regjimi, BSH ndjek edhe marrëdhëniet dhe ekspozimet me kundërpartitë, në marrëdhënie të veçantë me bankën.

BSH konstaton se nga monitorimi i ekspozimeve të personave në marrëdhënie të veçantë me bankën, lidhur me të në mënyrë direkte dhe indirekte, referuar matjes së këtyre ekspozimeve kundrejt kapitalit rregullator, nuk rezultojnë shkelje të kërkesave të ligjit "Për Bankat" apo akteve të tjera rregullatore.

AK konstaton se Tirana Bank SHA ka zbatuar detyrimet e lëna sipas vendimit nr. 580, datë 17.01.2019, të KK dhe BSH.

Duke qenë se BSH do të vazhdojë mbikëqyrjen speciale të Tirana Bank SHA deri në mars 2021, AK do të vazhdojë të kërkojë vlerësimet e kryera nga BSH sipas treguesve të mësipërm.

***Të vlerësojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna pas marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” nga AKEP, si dhe të marrë të gjitha masat ndaj kufizimeve të konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.***

***AK, nëpërmjet vendimarrjes së KK, ka marrë masa për rivendosjen e konkurrencës në treg.***

- *Tregu i shërbimeve celulare*

Në kuadër të dokumentit të publikuar nga AKEP në vitin 2019: ***“Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”***, KK nëpërmjet 2 vendimeve të tij (vendim nr. 635, datë 4.7.2019; vendim nr. 661, datë 21.11.2019) dhënë AKEP, i ka rekomanduar midis të tjerave:

- Të realizojë analizën e tregut me pakicë të shërbimeve celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e OFNT;
- Të rregullojë tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjet, të cilat janë OFNT në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare;
- Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin OFNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik;
- Të marrë në konsideratë përpara marrjes së vendimit përfundimtar, komentet e ndërmarrjeve të telefonisë celulare të depozituara pranë AKEP.

AKEP, me shkresën nr. 193 prot., datë 07.05.2020, ka depozituar pranë AK, vendimin nr. 9, datë 24.04.2020 “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare””, në të cilin është vendosur:

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuara në pikën 4, të nenit 3 të rregullores, në përfundim të analizës së tregut të kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduriale, të parashikuara nga ligji nr. 9918/2008 dhe rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme, duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4, të nenit 5 të rregullores.

Për sa më sipër, AKEP e konsideron tregun me pakicë të shërbimeve celulare jashtë objektit të rregullimit të veprimtarisë së tij, ku ai nuk mund të veprojë *ex-ante*.

Gjithashtu, për shkak të mos përmbushjes së testit të tre kritereve, sipas analizës në pjesën arsyetuese të vendimit nr.9, datë 24.4.2020, përkatësisht: « (1) verifikimi i prezencës së barrierave të larta dhe jokalimtare të hyrjes; (2) verifikimi nëse një strukturë tregu nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrence efektive brenda një afati kohor përkatës; (3) vlerësimi nëse aplikimi vetëm i ligjit në fuqi që rregullon fushën e konkurrencës është ose jo i mjaftueshëm për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim », asnjë nga tre ndërmarrjet që operojnë në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare nuk është OFNT.

AK, në përmbushje të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit “Për veprimtarinë e AK, gjatë vitit 2019”, ka ndërhyrë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

- *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare*

Nga monitorimi i tregut me pakicë të shërbimeve celulare, referuar informacionit të mbledhur gjatë monitorimit, rezulton se të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushje me 100 lekë, duke e rritur atë nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 janar – 11 shkurt 2020, sjellje e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

KK, me vendimin nr. 679, datë 14.02.2020, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.

KK, me vendimin nr. 680, datë 14.02.2020, vendosi “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare” ku ka kërkuar nga shoqëria, ndërprerjen e menjëhershme dhe jo më vonë se 5 ditë nga njoftimi i këtij vendimi, të aplikimit të paketave të reja standarde 30-ditore me parapagesë, për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

KK, me vendimin nr. 703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme, në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
  1. Për ndërmarrjen Vodafone Albania:
    - a. Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;
    - b. Akses për të gjithë;
    - c. Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID-19;
    - d. Përputhshmëri e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën.
  2. Për ndërmarrjen Telekom Albania:
    - a. Garantimi i pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat rregullatore në fuqi, veçanërisht atyre që rregullojnë fushën e tarifave të aplikuara ndaj konsumatorëve;
    - b. Ruajtja e transparencës kundrejt konsumatorëve;
    - c. Ofrimi i një game më të gjerë çmimesh, të përballueshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë;
    - d. Promovimi fuqishëm dhe zbatimi i strategjive me në qendër konsumatorin;
    - e. Të qenit proaktiv dhe mbështetës kundrejt sugjerimeve dhe nevojave që adresohen nga klientët;
    - f. Njoftimi i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ndryshimet e çmimeve.
  3. Për ndërmarrjen Altelecom:
    - a. Mundësi aksesit për përdoruesit me të ardhura të ulëta;
    - b. Më shumë internet "mobile data" për të gjithë - solidaritet për COVID-19;
    - c. Bonus solidariteti për çdo rimbushje të kartës SIM për solidaritetin e gjithanshëm;

- d. Informimi i Publikut.
- III. Ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom kanë detyrimin ligjor të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
- të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
  - të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
  - të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
  - në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, të zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
  - të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë, që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me penalitetin përkatës.
- V. T'i rekomandojë AKEP që hedhja e paketave të reja nga secila ndërmarrje në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasimor në zbatim të Rregullores nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifatat, si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".
- VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.**

Në zbatim të VKK nr. 703, datë 06.08.2020, ndërmarrjet Vodafone Albania, One Telecommunications dhe Altelecom kanë depozituar pranë AK informacion mbi angazhimet e marra në formën e kushteve dhe detyrimeve. **AK është në proces të përpunimit të të dhënave të sjella nga ndërmarrjet për 4 (katër)-mujorin e fundit të vitit 2020, për të vlerësuar se si ato po ecin me përmbushjen e angazhimeve të marra.**

AKEP, në kuadër të rekomandimit të pikës "V" të dispozitivit të VKK nr. 703, datë 06.08.2020, është shprehur se krahasimi i raporteve cilësi/çmim në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, është treg që nuk rregullohet nga AKEP, dhe mbetet jashtë detyrave të tij funksionale.

AK po monitoron zbatimin e këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

*Të propozojë rekomandime konkrete për tregjet që janë hetuar gjatë vitit 2019, për të cilat ka pasur dyshime të arsyeshme apo janë konstatuar marrëveshje të ndaluara ose abuzim me pozitën dominuese, si: (1) tregu i shërbimeve bankare; (2) tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit; (3) tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit; (4) tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto; (5) tregu i shërbimeve spitalore; (6) sektori i arsimit të lartë; (7) tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.*

*AK ka përfunduar procedurat hetimore në 6 tregje respektive dhe vendimmarrja e KK është shoqëruar me rekomandimet konkrete për tregjet e hetuara.*

## *1 Tregu i shërbimeve bankare*

KK, me vendimin nr. 592, datë 31.01.2019, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2016 deri në 31.12.2018.

Në përfundim të procedurave hetimore, KK, me vendimin nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, vendosi të kërkojë prej bankave objekt hetimi:

1. rishikimin e normave të interesit të depozitave dhe kredive;
2. rishikimin e komisioneve të shërbimeve drejt uljes së tyre; dhe
3. zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve online.

## **Tregu i shërbimeve bankare është në proces monitorimi përgjatë vitit 2021.**

## *2 Tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit*

KK, me vendimin nr. 693, datë 14.05.2020, “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”, vendosi:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF si entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv, shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare, sponsorizime dhe reklama.
2. Dhënien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF:
  - a. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive, në të ardhmen të reduktohet në fushëveprimin dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t’u shiten operatorëve të ndryshëm.
  - b. Detyrimin e FSHF që në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që ato të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve audiovizivë.
  - c. Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen, në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “*Highlighte*” dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të gjerë për operatorët audiovizivë.
3. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtës televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.
4. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga

- UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë, të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF – [www.fshf.org](http://www.fshf.org).
5. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF – [www.fshf.org](http://www.fshf.org).
  6. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhjeje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
  7. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhjeje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjorë të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
  8. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e RSH, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlerësim paraprak pranë AK.
  9. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlerësim paraprak të metodologjisë pranë AK.
  10. Detyrimet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 9 duhet të përmbushen brenda afatit 120 ditë nga dita që ky vendim i është njoftuar.
  11. Në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5% të xhiros mesatare ditore, për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
  12. **Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 2 (dy)-vjeçare.**

**VKK është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 1952, datë 21.09.2020.**

### *3 Tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit*

KK, me vendimin nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Bland SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrime dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”, vendosi:

- I. Konstatimin e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3, pika 4, dhe nenit 4, pika 1, gërmat (a) dhe (b) të ligjit nr. 9121/2003.

- II. Detyrimin e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK si vijon:
1. Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
  2. Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
  3. Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
  4. Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna mbi blerjet dhe shitjet, në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.
- III. T'i rekomandojë MFE dhe MBZHR, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën, të sigurojnë nxjerrjen e një akti nënligjor të përbashkët, për të realizuar ndarjen e produktit miell i importuar sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit të tij dhe përqindjes proteinike në "Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave", siç përcaktohet në udhëzimin nr. 207, datë 31.3.2015, të MBZHR:
- miell gruri për prodhim buke me përqindje proteinike 12%;
  - bazë picash, kruasan, petë me përqindje proteinike 12.5%;
  - miell për ëmbëlsira, kek, biskota, petulla me përqindje proteinike 9%;
  - makarona me përqindje proteinike 11%.
- IV. T'i rekomandojë MBZHR dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, si autoriteti mbikëqyrës i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore:
- a) Pas përditësimit të "Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave", në zbatim të pikës IV, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mundësojë kontrollin e nivelit të proteinës (% proteinike) për produktin miell importi, me qëllim përdorimin e këtij produkti në destinacionin përfundimtar tij.
- VI. Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.
- VII. **Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një)-vjeçare.**

#### *4 Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto*

KK, me vendimin nr. 702, datë 30.07.2020 "Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN", vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
- II. Dhënien e rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD si subjekt me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:
  1. Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;
  2. Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.
- III. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK:

1. çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;
  2. çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.
- IV. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitohet pranë AK për vlerësim paraprak çdo draft kontratë që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003.
- V. T'i rekomandohet Albpetrol SHA, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
- i. Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
  - ii. Të mbikqyrë planet e furnizimit të tregut vendas nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VI. T'i rekomandohet AKBN, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
- i. Në bashkëpunim me Albpetrol, të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
  - ii. Të mbikqyrë dhe të monitorojë planet e prodhimit të naftës bruto nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VII. Moszbatimi i përmbushjes së pikave II, III dhe IV të këtij vendimi, në zbatim të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.
- VIII. **Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një)-vjeçare**, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.

## 5 *Sektori i arsimit të lartë*

KK, me vendimin nr.706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL publike dhe private, si dhe dhënien e disa rekomandimeve për IAL private” ka vendosur:

- I. T'i rekomandohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:
  1. Të kryejë një studim të plotë tregu, në mënyrë që të përcaktohen kërkesat për studentë/specialistë, i cili duhet të publikohet **para fillimit të çdo viti akademik** dhe duhet të sigurojë:
    - a. Orientimin e IAL-ve për hapjen e programeve të reja të studimit;
    - b. Balancimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
    - c. Reduktimin e inflacionit të profesionistëve në degë të caktuara;
    - d. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke e drejtuar kërkesën e tyre drejt një oferte, e cila do të garantojë punësimin në një kohë të shkurtër pas diplomimit.
  2. Për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 dhe ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, MASR të hartojë dhe propozojë kuadrin e nevojshëm ligjor për burimet e financimit të IAL private me qëllim që:
    - i) Të ardhurat e përfituara nga këto IAL private nga:



- a. pagesat e studentëve për arsimim,
  - b. të ardhurat për shërbime të kryera,
  - c. të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të tjera,
  - d. fondet publike,
  - e. donacionet dhe burime të tjera të ligjshme financimi,
  - f. veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik të ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL private, sipas rregullores së miratuar nga çdo IAL private.
- ii) Çdo IAL private, të rregullojë me aktet e saj të brendshme, mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e mësipërme.
  - iii) Afati i përmbushjes së këtij rekomandimi nga MASR është **shtator 2021**.
3. Të kërkojë vlerësimin e AK, në zbatim të nenit 69, të ligjit nr. 9121/2003, për çdo projekt - akt normativ, që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:
- a. kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
  - b. vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
  - c. imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

## II. T'i rekomandojë IAL publike dhe private:

- 1. Të llogarisin koston për student për secilin program studimi dhe të bëjnë publike tarifat e studimit, për çdo vit akademik.
- 2. Të bëjnë transparente mënyrën e përdorimit të fondeve duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare.
- 3. Të bëjnë transparent fondin e kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfituar mbështetje financiare për kërkimin shkencor.
- 4. Të mundësojnë ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL-së, përpara fillimit të çdo viti akademik në mënyrë që të lehtësohen mundësitë e zgjedhjes së konsumatorëve (studentëve), bazuar në:
  - a) Performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës;
  - b) Vlerësimin/Reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve;
  - c) Lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare;
  - d) Shërbimet e përgjithshme - kampuset;
  - e) Çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën.
- 5. IAL, duhet të informojnë AK, për zbatimin e pikës II të këtij vendimi, brenda **muajit mars të vitit 2021**.

## III. Detyrimin e IAL-ve private që:

- 1. Të ndajnë llogarinë ekonomike të tyre me NIUS të veçantë nga llogaria ekonomike e

- shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose fondacionit që e ka krijuar dhe e financon.
2. Zbatimi i detyrimit të pikës III.1 të këtij Vendimi, duhet të realizohet brenda **muajit mars të vitit 2021**.
  3. IAL-të private duhet të informojnë Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar në pikën III.2.

IV. T'i rekomandojë INSTAT:

1. Të mbledhë të dhëna për arsimin e lartë dhe të mundësojë ofrimin e informacionit krahasues për cilësinë e IAL për çdo vit akademik, në mënyrë që të lehtësojë mundësitë e zgjedhjes së studentëve, për:
  - a. nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave; dhe
  - b. profileve të tyre në tregun vendas përkatës të punës.

V. AK do t'i drejtohet MASR në rast të mos përmbushjes së pikave II dhe III të këtij vendimi nga IAL, të cilat çenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke kërkuar përmbushjen e tyre.

VI. Mbylljen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë.

VII. **Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga MASR, IAL publike dhe private, dhe INSTAT për një periudhë 2 (dy)-vjeçare.**

*6 Tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike*

KK, me vendimin nr. 588, datë 28.01.2019 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike", ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në bazë të ligjit nr. 9121/2003.

KK, me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 "Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA, ka vendosur:

1. Mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.
2. Konstatimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës që rrjedhin nga pozita dominuese e KESH, në drejtim të procedurave për lidhjen dhe zbatimin e:
  - a. Kontratës së devijimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA dhe GSA SHPK.
  - b. Kontratës së depozitimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA me EFT AG.
3. Dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA:
  - a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA në zbatim të vendimit nr. 93/2019 të ERE, të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
  - b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Sekretariatit e Energjisë në Vjenë për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
  - c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë AK, për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.

- d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozitë dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive, për ndërmarrje (kompani) ose për produkte të caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga KK.

#### **4. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 (një)-vjeçare.**

Nga vlerësimi i informacioni të sjellë nga KESH, përgjatë vitit 2020, rezulton se ky i fundit, në zbatim të vendimeve të ERE dhe AK, ka zgjidhur kontratat me EFT dhe GSA, si dhe nuk ka lidhur asnjë kontratë të re me objekt të ngjashëm apo të njëjtë me këto kontrata, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet e dhëna me VKK nr. 644/2019.

#### *7 Tregu i shërbimeve spitalore*

KK, me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit të konkurrencës në shërbimin spitalor, i cili përfshin shërbimin spitalor publik dhe shërbimin privat.

Mbi të dhënat e administruara dhe në përfundim të analizave të realizuara, raporti u paraqit pranë KK, i cili shqyrtoi vlerësimin e konkurrencës në shërbimin spitalor nga ku u konkludua se vlerësimi i tregut kërkon analiza shtesë.

Për të realizuar një vlerësim më të thelluar të tregut të shërbimeve spitalore, kërkohet administrimi i të dhënave shtesë nga ofruesit e shërbimit dhe shtrirja e analizës për një periudhë më afatgjatë. KK, me vendimin nr. 669, datë 24.12.2019 “Për vijimin e hetimit të hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar”, vendosi vijimin e hetimit në këtë treg, për periudhën 2016-2019.

**Procedura hetimore ka përfunduar dhe po përgatitet raporti përfundimtar për Komisionin e Konkurrencës.**

*Të përditësojë vazhdimisht informacionin për vendimet dhe statusin e rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës në Platformën Ndërinstitucionale Online.*

*AK ka zbatuar këtë rekomandim. Gjatë vitit 2020 janë përditësuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga KK, kundrejt institucioneve publike dhe enteve rregullatore.*

AK ka përditësuar vendimet dhe statusin e rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës në Platformën Ndërinstitucionale Online për vitin 2020.

*Të realizojë amendimet ligjore të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në përputhje me acquis të Bashkimit European dhe problematikat e dala gjatë zbatimit të ligjit, si dhe të rishikojë kuadrin sekondar ligjor.*

*AK ka realizuar amendimet ligjore të ligjit nr. 9121/2003 në kuadër të projektit IPA Twinning “Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”, si dhe ka plotësuar kuadrin ligjor sekondar me akte të reja në kuadër të PKIE-së (2020-2022).*

Në kuadër të Projektit të BE, IPA Twinning “*Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*”, midis Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Komisionit Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën (CNMC), një nga komponentët kryesorë të tij ishte: “Përmirësimi i legjislacionit dhe përafrimi i kuadrit ligjor me BE”, ku propozime konkrete në ligjin aktual nr.9121/2003, synojnë:

- Përafrimin e dispozitave ligjore me kuadrin ligjor të BE në fushën e konkurrencës dhe më specifikisht, me Direktivën (EU) 2019/1 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 Dhjetor 2018 (ECN+) “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve anëtare, për të qenë më efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm”<sup>5</sup> (32019L0001), miratuar me VKK nr. 697, datë 30.06.2020, “Mbi miratimin e udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”.
- Kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të KK nga 5 vjet në 7 vjet. Ky propozim bazohet në eksperiencat e vendeve të Bashkimit Evropian të tilla si Italia, ku mandati i anëtarit të KK është 7 vjet, apo në vende të BE si Gjermania, Austria etj., ku mandati i anëtarit është i pakufizuar në kohë. Kjo siguron një vijueshmëri dhe qëndrueshmëri, sidomos lidhur me faktin se procedurat hetimore në fushën e konkurrencës kërkojnë relativisht një periudhë të gjatë kohore (mbi 3 vjet në rastet e hetimeve të thelluara ndërkohë që praktika evropiane njeh raste kur hetimet zgjasin mbi 5 vjet) për të arritur në konkluzione të qarta.
- Papajtueshmëritë dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të KK kur ai/ajo mbush moshën e daljes në pension, si dhe largimin nga detyra prej Kuvendit të RSH, në rastet kur është dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë.
- Fuqizimin dhe rritjen e instrumenteve të mbikëqyrjes së tregut nëpërmjet marrjes së masave sa më efektive për rivendosjen e konkurrencës në treg, si dhe vendosjen e penaliteteve ndaj subjekteve, të cilat në kundërshtim me ligjin ofrojnë produktet dhe shërbimet e tyre në treg, duke shkelur rregullat e konkurrencës.
- Forcimin e bashkëpunimit me strukturën përkatëse për konkurrencën në Komisionin Evropian, si dhe autoritetet e huaja homologe, përcaktimin e mekanizmave përkatës ligjorë për ekzekutimin e vendimeve të autoriteteve homologe në territorin e RSH, me qëllim zbatimin e Direktivës ECN+ “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve Anëtare për të qenë më efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm”.
- Plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me publikimin e vendimeve të AK, duke respektuar të drejtën e njoftimit të palëve të interesuara, dhe njëkohësisht zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me ruajtjen e informacionit konfidencial.

***Të shpeshtojë zhvillimin e seminareve dhe takimeve me entet rregullatore, aktorë të ndryshëm të tregut, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si dhe me Shkollën e Magjistraturës, për njohjen sa më të saktë e të plotë të veçorive të ligjit të konkurrencës dhe rolin e Autoritetit të Konkurrencës në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.***

***AK ka zbatuar rekomandimin sipas Rezolutës. Në kushtet e pandemisë COVID-19, këto aktivite janë zhvilluar online.***

<sup>5</sup> Directive (EU) 2019/1 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018” To empower the competition authorities of the Member States to be more effective enforcers and to ensure the proper functioning of the internal market,” PE/42/2018/REV/1, OJ L 11, 14.1.2019, (32019L0001)

Në kuadër të Projektit të BERZH “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, është hartuar dokumenti “*Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit*”, miratuar me VKK nr. 757, datë 23.12.2020, “Miratimi i dokumentit – “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit””.

Përpara hartimit të këtij “Dokumentit”, AK, në bashkëpunim me Lear (subjekti përfitues i projektit të BERZH, për AK) kanë organizuar takime dhe intervista online, me entet rregullatore: AKEP, AMA, AMF, ERE, ERRU, BSH, Zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj., me aktorë të ndryshëm në treg, që i përkasin komunitetit të biznesit, si dhe institucione të arsimit të lartë.

Ky “Dokument” do t’i paraqitet enteve rregullatore dhe aktorëve të ndryshëm të tregut, me synimin për një njohje më të plotë të ligjit të konkurrencës dhe rolit të AK përgjatë vitit 2021.

Në kuadrin e advokacisë së konkurrencës, në kushtet e pandemisë COVID-19, AK ka realizuar në datën 5 Dhjetor 2020 në “Ditën ndërkombëtare të konkurrencës” video-projeksionin me titull “Promovim publik i ligjit të konkurrencës” nëpërmjet video-projeksionit në godinën e UT.

## 1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti gjatë vitit 2020

Gjatë vitit 2020, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të PKIE (2020-2022), si dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit të ligjit nr.9121/2003 ka realizuar transpozimin e direktivave të BE në legjislacionin kombëtar të konkurrencës, ku konkretisht janë miratuar:

1. Udhëzuesi “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, miratuar me VKK nr. 697, datë 30.06.2020.<sup>6</sup>
2. Udhëzuesi “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”, miratuar me VKK nr. 683, datë 18.03.2020.<sup>7</sup>
3. Udhëzuesi “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje”, miratuar me VKK nr. 694, datë 15.05.2020.<sup>8</sup>
4. Udhëzuesi “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 miratuar me VKK nr. 678, datë 13.02.2020.<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën (EU) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 Dhjetor 2018 (ECN+) “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve Anëtare për të qenë me efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm” (32019L0001).

<sup>7</sup> Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën e Komisionit 2002/77 / EC e 16 shtatorit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”. (320032L0077).

<sup>8</sup> Ky Udhëzues ka përfaruar Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 1/2003 të datës 16 Dhjetor 2002 “Për implementimin e rregullave të konkurrencës të parashikuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit” si dhe Njoftimin e Komisionit “Mbi rregullat e aksesit në dosjen e Komisionit për rastet sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të BE, nenet 53, 54 dhe 57 të marrëveshjes së EEA dhe Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 139/2004”


<sup>9</sup> Ky Udhëzues ka përfaruar Njoftimin e Komisionit “Mbi praktikat më të mira për sjelljet sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU / (2011/C 308/06)”.

## PJESA E DYTË

### ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS


#### 2.1 Tregjet e monitoruara

AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003 ka realizuar monitorime, analiza dhe studime të tregjeve për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.



#### *Procedurat e realizuara*

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 19 monitorime. Tregjet e monitoruara kanë qenë:



## 6 (gjashtë) tregje të monitoruara në zbatim të VKK për vitin 2019

- *Monitorimi i zbatimit të vendimit të KK nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes EKMA ALBANIA SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës”.*

KK, me vendimin nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro - ushqimore në qytetin e Tiranës” ka konstatuar abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës, duke gjobitur këtë ndërmarrje për shkelje të nenit 9, pika 2, gërmat (a), (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003, si dhe ka vendosur detyrimin e kësaj ndërmarrjeje për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe të ndërmarrë masat e nevojshme.

AK ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës. Nga monitorimi në terren në ambientet e tregut agroushqimor EKMA Albania SHPK në qytetin e Tiranës, si dhe informacioni i depozituar nga ndërmarrja EKMA nëpërmjet shkresës nr. 365/53, datë 10.01.2020, rezultoi se: nga ana e ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuara.

Ndërmarrja EKMA Albania SHPK ka ankimuar vendimin e KK nr. 572/2018 në Gjykatë:

- Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë ka vendosur **lënien në fuqi të VKK nr. 572/2018.**
- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë **ka vendosur në favor të AK, në lidhje me masën e sigurimit të padisë, duke rrëzuar kërkesën e ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.**

KK ka vlerësuar që të shprehet lidhur me sjelljen e kësaj ndërmarrjeje, në përfundim të procedurave gjyqësore.

- *Monitorim i zbatimit të detyrimeve të dhëna KESH me VKK 644, dt. 31.07.2019, në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.*

KK, me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA, si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, mbylli procedurën hetimore dhe tregu është monitoruar deri në korrik 2020.

Gjatë periudhës së monitorimit, KESH, me shkresën nr. 24/17 prot., datë 02.10.2019, ka kërkuar nga AK dhe ERE vlerësimin e dy draft-kontratave: 1. kontratë “Për shkëmbimin e energjisë ndërmjet KESH dhe NOA Energy Trade SHPK”; 2. kontratë “Për shkëmbimin e energjisë

elektrike ndërmjet KESH SHA dhe shoqërisë tregtare të energjisë elektrike Energy To Energy SHPK”.

AK, pas vlerësimit të këtyre draft-kontratave, ka konstatuar se ato janë të njëjta në përmbajtje me kontratat e mëparshme për devijimin dhe depozitimin e energjisë elektrike, për të cilat KK është shprehur me vendimin nr. 644/2019, dhe si të tilla kufizojnë konkurrencën. AK i kërkoi KESH SHA zbatimin e vendimit 644/2019 të KK.

Nga vlerësimi i informacioni të sjellë nga KESH rezultoi se ky i fundit, në zbatim të vendimeve të ERE dhe AK, ka zgjidhur kontratat me EFT dhe GSA, si dhe nuk ka lidhur asnjë kontratë të re me objekt të ngjashëm apo të njëjtë me këto kontrata, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet e dhëna me VKK nr. 644/2019.

- *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil.*

KK, me vendimin nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit VKK nr. 499, datë 15.02.2018 për kartonin jeshil”, ka realizuar monitorimin e këtij tregu, deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.

Gjatë periudhës së monitorimit është konstatuar se shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në VKK nr. 499, datë 15.02.2018, si dhe ky vendim ka pasur një sërë efektesh pozitive mbi tregun në përgjithësi dhe konsumatorët në veçanti. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur rritje të çmimit të kartonit jeshil nga siguresit dhe as rritje të primit të riskut, i cili miratohet nga AMF. Për eliminimin e policave fallco, tashmë polica e sigurimit karton jeshil, është e vetmja policë sigurimi që printohet me *QR Code*.

- *Tregu i sigurimeve për produktin TPL.*

KK, me vendimin nr. 637, datë 09.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 për produktin TPL e brendshme”, ka realizuar monitorimin e këtij tregu, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, ku midis të tjerave ka adresuar këto rekomandime në drejtim të AMF:

- Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë, duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL;
- Të verifikojnë nëse tregtimi i MTPL në sistemet e tyre të shitjeve është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg;
- Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregtimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit veprojnë; etj..

Për sa i përket shoqërive të sigurimit, për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe për të shmangur çdo sjellje të mundshme anti konkurruese të tyre, duhet që:

- Sistemet që përdorin kompanitë e sigurimit dhe agjentët/punonjësit e tyre për tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm të lejojnë shfaqjen vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilës veprojnë; etj..



Nga monitorimi rezulton se AMF, në përmbushje të funksionit të saj si rregullator në tregun e sigurimeve ka përmbushur rekomandimet e dhëna nga KK. Po ashtu, edhe shoqëritë e sigurimit në përmbushje të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” lejojnë shfaqjen vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilës veprojnë.

- *Tregu bankar.*

KK, me vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE”, vendosi autorizimin e këtij përqendrimi me kushte dhe detyrime dhe monitorimin e sjelljes së Tirana Bank SHA për një periudhë 1 (një)-vjeçare.

Nëpërmjet korrespondencave shkresore, Tirana Bank SHA depozitoi informacionin e nevojshëm për vlerësimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga KK.

Në përfundim të analizës, rezultoi se nuk vihet re që Tirana Bank SHA të ketë aplikuar kushte shtesë apo t’i ketë vendosur shoqëritë e tjera në kushte të pabarabarta konkurrence dhe nuk u konstatua rritje tarifash për komisione, për të njëjtat shërbime bankare.

Sipas BSH, Tirana Bank SHA ka respektuar të gjitha kufizimet rregullative, në veçanti apo që lidhen me krijimin dhe rritjen e ekspozimeve me aksionarin ose e subjekteve të lidhura me të. BSH ka parashikuar një regjim specifik mbikëqyrës për Tirana Bank SHA, i cili do të ndiqet dhe monitorohet deri në mars 2021.

AK do të vazhdojë të kërkojë vlerësimet e kryera nga BSH sipas treguesve specifikë për Tirana Bank SHA.

- *Tregu i telekomunikacionit.*

KK, me vendim nr.610, datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD dhe mbajtjen në monitorim për një periudhë 1 (një)-vjeçare nga marrja e këtij vendimi, të veprimtarisë së shoqërisë Telekom Albania SHA.

Mbështetur mbi dokumentacionin e depozituar nga Telekom Albania SHA gjatë periudhës së monitorimit, u konstatua se shoqëria Telekom Albania SHA ka plotësuar detyrimin e përcaktuar në VKK nr. 610, datë 10.04.2019, dhe ka ofruar në treg një numër të konsiderueshëm paketash shërbimi të telefonisë celulare si dhe ka përmirësuar paketat ekzistuese.

#### **4 (katër) tregje të monitoruara për të cilat ka filluar procedura hetimore.**

- *Tregu i importit, i depozitimit, i shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës (GLN).*

Nisur nga disa shqetësime në median e shkruar mbi rritjen e çmimit të shitjes së GLN për përdorim familjar dhe automjete, AK gjatë muajit janar 2020, realizoi një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e shitjes së produktit GLN.

Nga monitorimi rezultoi se struktura e tregut të importit të GLN është shumë e përqendruar, ku tre ndërmarrjet kryesore zotërojnë rreth 91% të tregut, dhe u vu re rritje e njëkohshme e çmimit të shitjes së GLN nga ndërmarrjet në treg. Si rrjedhojë, në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN, ka shenja të një sjelljeje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, e cila mund të çojë në shkelje të ligjit nr. 9121/2003.

KK, me vendimin nr. 675, datë 07.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit GLN”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

- *Tregu i transfertave të parave (hyrje dhe dalje).*

Nisur nga disa shqetësime në median e shkruar lidhur me aplikimin e tarifave shumë të larta për shërbimin e transfertave të shpejta të parave nga shoqëria Western Union, gjatë muajit shkurt 2020, u realizua një monitorim në këtë treg në lidhje me tarifat e aplikuara për transfertat e parave (hyrje dhe dalje).

KK, me vendimin nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg, për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve për shkelje të mundshme të konkurrencës, bazuar në nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare.*

Nga ankesat e depozituara pranë AK nga qendra “Konsumatori Shqiptar” dhe konsumatorë të telefonisë celulare, lidhur me rritjen e çmimeve në mënyrë të pajustificuar të këtyre paketave nga operatorët celularë, si dhe nga shqetësimet në masmedia, AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, ka monitoruar tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Referuar informacionit të mbledhur gjatë monitorimit rezulton se të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30-ditore me parapagesë, me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushje nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 janar – 11 shkurt 2020, sjellje e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

KK, pas monitorimit të tregut me pakicë të shërbimeve celulare, me vendimin nr. 679, datë 14.02.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi hapjen e hetimit në këtë treg.

KK, me vendimin nr. 680, datë 14.02.2020, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi për marrjen e masës së përkohshme në këtë treg”.

- *Tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë i materialeve paramjekësore.*

AK realizoi një monitorim në tregun e tregtimit të materialeve dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje në kushtet e pandemisë COVID-19, e cila u shoqërua me rritje të çmimit të materialeve paramjekësore. Nga verifikimi në terren u konstatua se: tregu ka mungesë të materialeve në nivelin e tregtisë me pakicë (rrjeti farmaceutik) dhe ka rritje të pajustificueshme të çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve (depo farmaceutike dhe rrjeti i farmacive). Duke pasur shenja të arsyeshme të një sjelljeje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këto nivele tregtimi, bazuar në nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, KK, me vendimin nr. 684, datë 18.03.2020, “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e hetimit në këtë treg.

KK, me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi dhënien e masës së përkohshme për ndërmarrjet që operojnë në këtë treg.

## **5 (pesë) monitorime në zbatim të vendimeve të KK të vitit 2020, përgjatë vitit 2021-2022**

- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.*

KK, me vendimin nr. 702, datë 30.07.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, ka vendosur dhënien e rekomandimeve AKBN dhe Albpetrol dhe detyrimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD.

AK ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, pas depozitimit të informacionit të kërkuar për tremujorin e parë dhe pas realizimit të një seance dëgjimore sqaruese lidhur me kostot e naftës, prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure dhe draft-kontratat me rafineritë. **Monitorimi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021.**

- *Tregu i importit të grurit; importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.*

KK, me vendim nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell

Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrime, dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU” vendosi mbylljen e hetimit për këtë treg. Sjellja e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK është në monitorim.

Për sa më sipër, ndërmarrjet kanë depozituar informacionet përkatëse për tremujorin e parë dhe është realizuar një seancë dëgjimore në lidhje me të dhënat mbi blerjet dhe shitjet e këtyre ndërmarrjeve. **Monitorimi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021.**

- *Sektori i arsimit të lartë.*

KK, me vendimin nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”, ka vendosur dhënien e rekomandimeve dhe detyrimeve për IAL publike dhe private, MASR dhe INSTAT.

**Sjellja e IAL publike dhe private do të jetë në monitorim për një periudhë 2 (dy)-vjeçare.**

- *Tregu i telefonisë celulare.*

KK, me vendimin nr. 676, datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, vendosi të autorizojë transaksionin e njoftuar, me kushte dhe detyrime për shoqërinë Vodafone Albania SHA, për të mos abuzuar me pozitën e saj dominuese.

Në fund të vitit 2020, shoqëria Vodafone Albania SHA njoftoi transaksionin e përthithjes me shoqërinë ABCom SHPK. KK me vendimin nr. 759, datë 30.12.2020, vendosi: mosklasifikimin si përqendrim të transaksionit të njoftuar, detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për zbatimin e pikës 1, gërma (a) të VKK nr. 676, datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, si dhe marrjen përsipër të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, që do të lindin nga procedura e bashkimit me përthithje.

**Monitorimi i veprimtarisë së Vodafone Albania SHA do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021.**

- *Tregu i shërbimeve të transportit ajror.*

KK, me vendimin nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA” vendosi autorizimin e transaksionit dhe respektimin nga shoqëria Kastrati Group SHA të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 .

**Monitorimi i sjelljes së shoqërisë Tirana Internacional Airport SHPK do të kryhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare.**

#### **4 (katër) tregje që nuk kanë kaluar në procedura hetimore:**

- *Tregu i qirave të banesave.*

Në bazë të një kërkesë të paraqitur pranë AK nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Mbështetëse, lidhur me abuzime të mundshme me çmimet e qirave të banesave, gjatë muajit janar 2020 u realizua monitorimi i tregut të qirave të banesave, nga ku rezultoi se nuk ka shenja për kryerjen e procedurave të mëtejshme nga ana e AK, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i shitjes së produkteve të shportës ushqimore.*

AK, gjatë muajit prill 2020, ka monitoruar tregun e tregtimit të produkteve të shportës ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin e pasojave që shkaktoi pandemia e COVID-19 mbi çmimet e shitjes së produkteve të shportës ushqimore. Në përfundim të monitorimit të kryer rezultoi se në këtë treg nuk janë konstatuar shenja të kufizimit të konkurrencës, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i përpunimit të produkteve ushqimore të skaduara (në landfillin e Sharrës).*

Në bazë të një ankese të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, gjatë muajit qershor 2020 është monitoruar tregu i ofrimit të shërbimit për shkatërrimin e produkteve ushqimore të skaduara, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg. Në përfundim të monitorimit rezultoi se problematikat e ngritura në ankesën e paraqitur dalin jashtë objektit të ligjit nr. 9121/2003.


- *Tregu i transportit ndërkombëtar detar të mallrave.*

Në bazë të një ankese të operatorëve të transportit, lidhur me ndërprerjen e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar të mallrave nga Porti i Vlorës, gjatë muajit shtator 2020, u realizua monitorimi i këtij tregu, nga ku rezultoi se ndërprerja ka ardhur si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Për këtë arsye, nuk u evidentuan shenja të cilat do të çonin në hapjen dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme nga ana e AK, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003.

#### **2.2 Kontrolli i përqendrimeve**



AK, në zbatim të neneve 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121/2003, gjatë vitit 2020, ka realizuar vlerësimin e 27 rasteve të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve, nga të cilat:

- 19 raste janë klasifikuar si përqendrime dhe janë autorizuar nga KK,
- 8 vlerësime ligjore nuk kanë përmbushur kriteret për t'u autorizuar nga KK.



Nga përqendrimet e autorizuara rezulton se:

- 82% e rasteve janë transaksione që kanë ndodhur në tregun e jashtëm, 15 vendime autorizimi;
- 18% e rasteve janë transaksione që kanë ndodhur në tregun shqiptar, 4 vendime autorizimi.



*Të ardhurat nga përqendrimet*

### 2.2.1 Transaksione në tregun e brendshëm

AK ka autorizuar 4 transaksione të njoftuara në tregun e brendshëm, të cilat të detajuara sipas tregjeve, janë si më poshtë:

- *Tregu i telekomunikacionit.*
- Përftimi i kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

KK, me vendimin nr. 676, datë 07.02.2020, vendosi të autorizojë me kushte dhe detyrime përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet e lëvizshme dhe tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet fikse. Nga vlerësimi, u konkludua se ky transaksion nuk do të sillte krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë Vodafone Albania SHA në tregjet e prekura, por duke qenë se shoqëria Vodafone Albania SHA siguronte pjesën më të madhe të të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike dhe zotëronte pozitë dominuese në tregun e komunikimeve elektronike në rrjetin celular, do të sillte eksperiencën e saj dhe të grupit që përfaqëson në tregjet përkatëse të produkteve. Për rrjedhojë, pritej që ky transaksion të kishte impakt në tregun e komunikimeve elektronike dhe kryesisht, në tregun e komunikimeve në rrjetet fikse.

Në fund të vitit 2020, shoqëria Vodafone Albania SHA njoftoi transaksionin e përthithjes me shoqërinë ABCom SHPK. Transaksioni i njoftuar nuk plotësonte kriteret e parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 9121/2003 dhe si i tillë nuk ishte objekt i ligjit.

Për të vlerësuar ndikimet që do të sjellin transaksionet e kryera mes Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK në tregun e komunikimeve elektronike, KK, me vendimin nr. 759, datë 30.12.2020, vendosi detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA për zbatimin e pikës 1, germa (a) të vendimit nr. 676, datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, dhe marrjen përsipër të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që do të lindin nga procedura e bashkimit me përthithje.

#### **Veprimtaria e shoqërisë Vodafone Albania SHA do të jetë objekt monitorimi gjatë vitit 2021.**

- Përftimi i kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

KK, me vendimin nr. 758, datë 28.12.2020, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i transmetimeve televizive. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

- *Tregu financiar.*

- Përftimi i kontrollit të Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA.

KK, me vendimin nr. 686, datë 06.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA”, vendosi të autorizojë përqendrimin e njoftuar. Tregu përkatës në

këtë transaksion u konsiderua tregu i titujve. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

- *Tregu i infrastrukturës dhe i shërbimeve të transportit ajror.*

- Përfitimi i kontrollit të Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA.

KK, me vendimin nr. 755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga shoqëria Kastrati Group SHA”, vendosi të autorizojë përqendrimin e njoftuar. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve të infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë, shërbime këto të ofruara nga TIA. Duke qenë se shoqëria Kastrati Group SHA do të jetë zbatuese e kontratës së koncesionit për Aeroportin e Rinasit, KK vendosi që Kastrati Group SHA, në cilësinë e shoqërisë blerëse duhet të respektojë nenin 9 të ligjit nr. 9121/2003.

**AK do të monitorojë për një periudhë 1 (një)-vjeçare sjelljen e ndërmarrjes në treg.**

## **2.2.2 Transaksione në tregun e jashtëm**

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë rastet, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. KK, për vitin 2020, ka autorizuar 14 raste të renditura më poshtë:


1. Vendimi nr. 673, datë 23.01.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe transportit të naftës bruto dhe gazit, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
2. Vendimi nr. 681, datë 05.03.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”. Transaksioni ndodh në tregun e sigurimit dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
3. Vendimi nr. 682, datë 05.03.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Dasof d.o.o. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft m.b.H.”. Transaksioni ndodh në tregun e programimeve kompjuterike (software) për dhënie me qira si edhe për konsulencë, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
4. Vendimi nr. 687, datë 06.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft”. Transaksioni ndodh në tregun e zhvillimit të strategjive të personalizuar të prodhimit në të gjitha fushat e industrisë dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
5. Vendimi nr. 690, datë 28.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.”. Transaksioni ndodh në tregun e importit e shitjes së automjeteve të reja dhe pjesëve të këmbimit dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.



6. Vendimi nr. 691, datë 06.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve bankare dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
7. Vendimi nr. 692, datë 06.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.”. Transaksioni ndodh në tregun e gazrave industrialë dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
8. Vendimi nr. 695, datë 15.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët me funksione të plota Joint –Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes)”. Transaksioni ndodh në tregun e eksplorimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe tregtimit të produkteve të rafinuara dhe petrokimike, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
9. Vendimi nr. 705, datë 10.09.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”. Transaksioni ndodh në tregun e qiradhënies së mallrave dhe pajisjeve, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
10. Vendimi nr. 713, datë 15.10.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e importit dhe shpërndarjes së makinave dhe pjesëve të këmbimit, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
11. Vendimi nr. 721, datë 12.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softwerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG”. Transaksioni ndodh në tregun e sistemit software të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
12. Vendimi nr. 722, datë 12.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS”. Transaksioni ndodh në tregun e zhvillimit, ndërtimit dhe operimit të sistemeve fotovoltaike diellore, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
13. Vendimi nr. 724, datë 12.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e produkteve dhe shërbimeve për trajtimin e pacientëve në shtëpi ku përfshihen ventilatorët dhe pajisjet e oksigjenit, inhalatorët dhe pajisjet thithëse, pajisjet e terapisë dhe diagnostikimit, si edhe gazrat e duhur për përdorimin e pajisjeve, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.
14. Vendimi nr. 750, datë 26.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve bankare dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

15. Vendimi nr. 756, datë 16.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo”. Transaksioni ndodh në tregun e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes të sistemeve të baterive me lëndë djegëse për kamionët dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

## 2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese



*Numri i vendimeve sipas shtyllave të konkurrencës*

### 2.3.1 Marrëveshjet e ndaluara

- *Tregu i shërbimeve bankare.*

KK, me vendimin nr. 592, datë 31.01.2019, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2016 deri në 31.12.2018.

Në përfundim të procedurave hetimore, KK, me vendimin nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, vendosi mbylljen e hetimit dhe detyrimin e bankave lidhur me: rishikimin e normave të interesit të depozitave dhe kredive; rishikimin e komisioneve të shërbimeve bankare drejt uljes së tyre; rishikimin e kostove penguese për lëvizshmërinë e klientëve nga një bankë në tjetrën (*switching cost*); dhe zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve online.

**Tregu i shërbimeve bankare është në proces monitorimi përgjatë vitit 2021.**

- *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare.*

AK ka monitoruar tregun me pakicë të shërbimeve celulare, nisur nga ankesat e depozituara pranë tij nga qendra “Konsumatori Shqiptar” dhe konsumatorë të telefonisë celulare, si dhe nga shqetësimet në masmedia, lidhur me rritjen e çmimeve në mënyrë të pajustificuar të këtyre paketave nga operatorët celularë. Nga monitorimi rezultoi se të tre operatorët celularë kanë

hedhur në treg paketat e reja standarde 30-ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushje me 100 lekë, duke e rritur atë nga 100 në 200 lekë, në periudhën kohore 30 janar – 11 shkurt 2020.

Duke pasur shenja të arsyeshme të një sjelljeje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003, KK mori vendimin nr. 679, datë 14.02.2020, për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, dhe vendimin nr. 680, datë 14.02.2020, për dhënien e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në këtë treg.

Në përfundim të hetimit paraprak, KK, me vendimin nr. 703, datë 06.08.2020, vendosi për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, si më poshtë:

- a. Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;
- b. Akses për të gjithë;
- c. Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID-19;
- d. Përputhshmëria e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën;
- e. Ofrimi i një game më të gjerë çmimesh, të përballueshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë;
- f. Njoftimi i AK lidhur me ndryshimet e çmimeve.

Gjithashtu, KK vendosi detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Në kuptim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003, KK vendosi t'i rekomandojë AKEP që hedhja e paketave të reja nga secila ndërmarrje në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasimor në zbatim të rregullores nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".

Në zbatim të VKK nr. 703, datë 06.08.2020, ndërmarrjet Vodafone Albania, One Telecommunications dhe Albtelecom kanë depozituar pranë AK, informacion mbi angazhimet e marra në formën e kushteve dhe detyrimeve.

AKEP, në kuadër të rekomandimit të pikës V, të dispozitivit të VKK nr. 703, datë 06.08.2020, është shprehur se krahasimi i raporteve cilësi/çmim në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, është treg që nuk rregullohet nga AKEP dhe mbetet jashtë detyrave të tij funksionale.

AK po monitoron zbatimin e këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.

- *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil.*

KK, me vendimin nr. 689, datë 24.04.2020, vendosi vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil, duke vlerësuar se kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin karton jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe nuk kufizon lirinë tregtare, lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij. Kjo marrëveshje përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë:

1. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy)-vjeçare, nga marrja e këtij vendimi.
2. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
3. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, KK do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
4. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

AK po monitoron zbatimin e vendimit deri në përfundim të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

- *Tregu i sigurimeve për produktin TPL.*

Në mbështetje të ligjit nr. 9121/2003, VKK nr. 276, datë 18.03.2013 “Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të ligjit nr.9121/2003 ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, BSHS ka depozituar për vlerësim ligjor “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””.

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 751, datë 26.11.2020 “Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””, vendosi se marrëveshja e bashkëpunimit për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 dhe me nenin 3 të rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të ligjit nr.9121/2003 ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

Në marrëveshjen e bashkëpunimit të shtohen kushtet dhe detyrimet si më poshtë vijon:

1. Marrëveshja mos të kufizojë produktin MTPL apo shitjet.
2. Marrëveshja mos të ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL.
3. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi duhet të mos kenë rënë dakord për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.
4. Ndërmarrjet duhet të vazhdojnë ta tregtojnë policën e sigurimit të detyrueshëm me logot respektive.
5. Ndërmarrjet të raportojnë pranë AK për masat që kanë si synim të marrin, për sigurimin e mosfalsifikimit të policave të sigurimit të brendshëm MTPL, për të vlerësuar nëse këto masa mund të çenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
6. Ndërmarrjet të vendosin në dispozicion të AK, informacionin e shkëmbyer në bazë të marrëveshjes, sa herë që kërkohet nga ky autoritet.
7. Afati i marrëveshjes do të jetë 2 vjet.

**AK do të vijojë të monitorojë zbatimin e këtij vendimi për një periudhë 2 (dy)-vjeçare.**

- *Tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë i materialeve paramjekësore.*

KK, me vendimin nr. 684, datë 18.03.2020, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

KK, me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:

- a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
- b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparente në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
- c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimin e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.

Nga analiza e konkurrencës së ndërmarrjeve në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore, përgjatë periudhës hetimore janar-maj 2020 është konstatuar se çmimet për produktet maska, alkool, gel-dezinfektues dhe termometra janë rritur në mënyrë të pajustificuar. Në këto kushte, ka dyshime për praktika të bashkërenduara midis ndërmarrjeve në treg në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 716, datë 15.10.2020, vendosi për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues; në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

KK, pasi vlerësoi zbatimin e masës së përkohshme, u shpreh me vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

### 2.3.2 Abuzimi me pozitën dominuese

- *Tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit.*

KK, me vendimin nr. 693, datë 14.05.2020, vendosi konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF, si entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv; shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama.

KK vendosi në të njëjtin vendim, dhënien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF, si më poshtë:

- a. Detyrimin e FSHF, që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprimin dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhe jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t’u shiten operatorëve të ndryshëm.
- b. Detyrimin e FSHF, që në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që ato të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve audiovizivë.
- c. Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “Highlighte” dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të gjerë për operatorët audiovizivë.

Detyrime të tjera drejtuar FSHF lidhen me:

1. Përfshirjen e Ligës Profesioniste, duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtë televizive”, si dhe të drejtave të tjera, që burojnë prej saj.
2. Shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF – [www.fshf.org](http://www.fshf.org).

3. Zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë, të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF – [www.fshf.org](http://www.fshf.org).
4. Shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
5. Shmangien e çdo lloj lidhjeje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjorë të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
6. Realizimin e procedurave të prokurimit transparente dhe jo diskriminuese, duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës, për lidhjen e çdo kontrate në të ardhmen nga FSHF, që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e RSH për ndërmarrje ose produkte të caktuara. Këto kontrata të sillen për vlerësim paraprak pranë AK.
7. Hartimin e një metodologjie për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlerësim paraprak të metodologjisë pranë AK.

Detyrimet e përcaktuara në pikat e mësipërme duhet të përmbushen brenda afatit 120-ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar. Në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në vendim, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5% të xhiros mesatare ditore, për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma (a), të ligjit nr. 9121/2003.

**AK do të monitorojë zbatimin e këtij vendimi për një periudhë 2 (dy)-vjeçare.**

**VKK është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1952, datë 21.09.2020.**

*- Tregu i barnave dhe pajisjeve mjekësore.*

KK, me vendimin nr. 707 datë 23.09.2020, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore. Gjatë procedurave hetimore, u konstatua se Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore kishte autorizuar për tregtim vaksinën INFLUVAC SUB-UNIT TETRA, e cila tregtohej vetëm nga ndërmarrja Megapharma SHPK nëpërmjet rrjetit të farmacive “Orange”.

KK, me dyshimin për një shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit 9121/2003, me vendimin nr. 715, datë 15.10.2020, vendosi dhënien e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Megapharma SHPK, duke e detyruar të furnizojë depot dhe farmacitë e tjera dhe jo vetëm rrjetin e farmacive Orange, me vaksinën INFLUVAC SUB-UNIT TETRA.

Zbatimi i masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Megapharma SHPK do të vlerësohet gjatë procedurës së hetimit të thelluar

- *Tregu i ushtrimit të veprimtarisë së agjentit në sigurime.*

AMF ka depozituar pranë AK kërkesën për opinion, në lidhje me pajisjen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe Postës Shqiptare. DPSHTRR ka depozituar pranë AK dokumentacionin përkatës, lidhur me vlerësimin e shkallës së kufizimit ose pengimit të konkurrencës, me qëllim sqarimin përkatës mbi nevojën për aplikimin si agjent në sigurime. Posta Shqiptare ka depozituar dokumentacionin përkatës lidhur me miratimin për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime.

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 698, datë 20.07.2020 dhe vendimin nr. 699, datë 20.07.2020, vendosi për disa rekomandime për AMF në lidhje me licencimin e DPSHTRR dhe Postës Shqiptare, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime.

AMF, si autoriteti përgjegjës që licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime në zbatimin e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, përpara licencimit, duhet t’i kërkojë DPSHTRR dhe Postës Shqiptare:

1. Të lidhë kontrata të veçanta me të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. Të mos vendosë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmime të padrejta të blerjes ose shitjes, apo të kushteve të tjera të padrejta të tregtimit.
3. Të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.
4. Të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
5. Të tregtojë produktin e sigurimit me logon e shoqërisë së sigurimit dhe barkodin përkatës në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” për të shmangur koordinimin e sjelljes, ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimin e çmimeve mes shoqërive të sigurimit dhe DPSHTRR/Posta Shqiptare.

Për sa më sipër, AMF ka depozituar pranë AK informacionin lidhur mbi zbatimin e rekomandimeve të VKK nr. 698/2020 dhe VKK nr. 699/2020. Referuar këtij informacioni, Postës Shqiptare dhe DPSHTRR i është kërkuar nga AMF plotësimi i kërkesave sipas vendimeve të KK. Posta Shqiptare dhe DPSHTRR nuk kanë depozituar asnjë dokument plotësues sipas kërkesave të lëna nga KK. Në këto kushte, AMF nuk ka vijuar me shqyrtimin e kërkesës për licencimin e subjekteve Posta Shqiptare SHA dhe DPSHTRR, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime.



## 2.4 Tregjet prodhuese

### 2.4.1 Marrëveshjet e ndaluara

- *Tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit.*

Në përfundim të procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, KK, me vendimin nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”, vendosi mbi konstatimin e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve objekt hetimi, bazuar në nenin 3, pika 4 dhe nenin 4, pika 1, gërmat (a) dhe (b) të ligjit nr. 9121/2003, si pasojë e caktimit të çmimeve të shitjes dhe kontrollimit të prodhimit në tregun e miellit, për shkak të integritimit vertikal.

KK vendosi mbi ndërmarrjet AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, kushtet dhe detyrimet si në vijim:

1. Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
2. Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet.
3. Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit.
4. Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK, të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.

Moszbatimi i këtyre kushteve dhe detyrimeve, në zbatim të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.

Gjithashtu, KK vendosi mbi dhënien e rekomandimeve për:

1. MFE dhe MBZHR, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën të sigurojnë nxjerrjen e një akti nënligjor të përbashkët, për të realizuar ndarjen e produktit miell i importuar sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit të tij dhe përqindjes proteinike në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave”, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 207, datë 31.3. 2015 të MBZHR:
  - miell gruri për prodhim buke me përqindje proteinike 12%;
  - bazë picash, kruasan, petë me përqindje proteinike 12.5%;
  - miell për ëmbëlsira, kek, biskota, petulla me përqindje proteinike 9%;
  - makarona me përqindje proteinike 11%.
2. MBZHR dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, ku ky i fundit si autoriteti mbikëqyrës i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore, pas përditësimit të “Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave”, të mundësojë kontrollin e nivelit të proteinës (% proteinike) për produktin miell importi, me qëllim përdorimin e këtij produkti në destinacionin përfundimtar të tij.

AK do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një)-vjeçare.

### **Ky treg është në monitorim gjatë vitit 2021.**

- *Tregu i prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) i zhvilluar nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.*

Nisur nga një ankesë e paraqitur pranë AK, KK, me vendimin nr. 708, datë 23.09.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Gjatë periudhës së hetimit paraprak është kërkuar informacion nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.

KK, me vendimin nr. 762, datë 22.01.2021, “ Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel Co SHPK”, vendosi hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg.

#### **2.4.2 Abuzimi me pozitën dominuese**

- *Tregu i ngarkim- shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN-së.*

KK, me vendimin nr. 711, datë 08.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN.

Në zbatim të këtij vendimi është kërkuar informacion nga ndërmarrjet nën hetim, koncesionarët Porti MBM; Romano Port SHA; Petrolifera Italo Albaneze SHA (PIA); si dhe nga: Porti Detar Vlorë SHA; Porti Detar Shëngjin SHA; Autoriteti Portual Durrës; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

- *Tregu i ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve.*

KK, me vendimin nr. 719, datë 28.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, vendosi hapjen

e hetimit paraprak në këtë treg, referuar numrit të kufizuar të operatorëve që realizojnë ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin e karburanteve në dy portet Vlora-1 dhe Porto Romano, dhënë me koncension, ku secili koncensionar operon me modele të ndryshme dhe zotëron pozitë dominuese në zonën gjeografike, portin ku operon.

Gjatë periudhës së hetimit të paraprak është kërkuar informacion nga ndërmarrjet koncesionare: Porti MBM; Romano Port SHA; Petrolifera Italo Albaneze SHA (PIA); si dhe nga: Porti Detar Vlorë SHA; Porti Detar Shëngjin SHA; Autoriteti Portual Durrës; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

- *Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.*

KK, me vendimin nr. 702, datë 30.07.2020, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN.

Rekomandimet e dhëna për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, si subjekt me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH, përfshijnë: aplikimin e kushteve të tregtimit të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore; dhe furnizimin e ndërmarrjeve të përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.

KK vendosi mbi dhënien e detyrimit ndaj Bankers Petroleum Albania LTD, për të depozituar pranë AK çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës dhe çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacioneve hidrokarbure. Bankers Petroleum Albania LTD ka gjithashtu detyrimin të depozitohet pranë AK për vlerësim paraprak çdo draft kontratë, që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003.

Mospërbushja e këtyre detyrimeve, në zbatim të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndërshkohet me penalitetet përkatëse.

Për sa i përket ndërmarrjeve Albpetrol SHA dhe AKBN, KK vendosi, si në vijim:

- I. T'i rekomandojë Albpetrol SHA, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
  - i. Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
  - ii. Të mbikëqyrë planet e furnizimit të tregut vendas nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- II. T'i rekomandojë AKBN, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
  - i. Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto, në bashkëpunim me Albpetrol;
  - ii. Të mbikëqyrë dhe monitorojë planet e prodhimit të naftës bruto nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.

AK do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një)-vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe detyrimeve të dhëna.

### **Ky treg është në monitorim gjatë vitit 2021.**

- *Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve kontenierike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontenierëve Durrës.*

KK, me vendimin nr. 696, datë 11.06.2020 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Durrës Container Terminal SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve në Terminalin e Kontenierëve Durrës dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”, vendosi:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Durrës Container Terminal SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve në Terminalin e Kontenierëve Durrës, gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit.
2. **Gjorbitjen e ndërmarrjes Durrës Container Terminal SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, germa (a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0,43% të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, në shumën 5,052,370 lekë.**
3. T'i rekomandojë MIE dhe MFE që brenda një afati 90-ditor, të marrin masat si vijon:
  - Rregullimin e tregut të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve në Terminalin e Kontenierëve Durrës, duke përcaktuar dhe miratuar tarifën përkatëse për këtë shërbim, në udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës, me qëllim shmangien e sjelljeve të mundshme abuzive nga operatorë të këtij tregu.
4. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Durrës Container Terminal SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve në Terminalin e Kontenierëve Durrës.

**Ky VKK është ankimuar nga ndërmarrja DCT pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë dhe lënien në fuqi të VKK.**

### **2.5 Hetime të përgjithshme**

- *Sektori i arsimit të lartë*

KK, me vendimin nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”, vendosi:

I. T'i rekomandojë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

1. Të kryejë një studim të plotë tregu, në mënyrë që të përcaktohen kërkesat për studentë/specialistë, i cili duhet të publikohet para fillimit të çdo viti akademik dhe duhet të sigurojë:
  - a. Orientimin e IAL për hapjen e programeve të reja të studimit;
  - b. Balancimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
  - c. Reduktimin e inflacionit të profesionistëve në degë të caktuara;
  - d. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke e drejtuar kërkesën e tyre drejt një oferte, e cila do të garantojë punësimin në një kohë të shkurtër pas diplomimit.
2. Për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 dhe ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", MASR të hartojë dhe propozojë kuadrin e nevojshëm ligjor për burimet e financimit të IAL private me qëllim që:
  - i) Të ardhurat e përfituara nga këto IAL private nga:
    - a. pagesat e studentëve për arsimim,
    - b. të ardhura për shërbime të kryera,
    - c. të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të tjera,
    - d. fonde publike,
    - e. donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi,
    - f. veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik të ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL private, sipas rregullores së miratuar nga çdo IAL private.
  - ii) Çdo IAL private të rregullojë me aktet e saj të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve, të krijuara nga të ardhurat e mësipërme.

**iii) Afati i përmbushjes së këtij rekomandimi nga MASR është shtator 2021.**
3. Të kërkojë vlerësimin e AK, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003, për çdo projekt - akt normativ, që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:
  - a. kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
  - b. vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
  - c. imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

II. T'i rekomandojë IAL publike dhe private:

1. Të llogarisin koston për student, për secilin program studimi dhe të bëjnë publike tarifrat e studimit, për çdo vit akademik.
2. Të bëjnë transparente mënyrën e përdorimit të fondeve, duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare.
3. Të bëjnë transparent fondin e kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfituar mbështetje financiare për kërkimin shkencor.
4. Të mundësojnë ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL, përpara fillimit të çdo viti akademik në mënyrë që të lehtësohen mundësitë e zgjedhjes së konsumatorëve (studentëve), bazuar në:

- a) Performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës;
  - b) Vlerësimin/Reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve;
  - c) Lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare;
  - d) Shërbimet e përgjithshme - kampuset;
  - e) Çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën.
5. IAL duhet të informojnë AK, për zbatimin e pikës II të këtij vendimi, brenda **muajit mars të vitit 2021**.

### III. Detyrimin e IAL private që:

- 1. Të ndajnë llogarinë ekonomike të tyre me NIUS të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose fondacionit që e ka krijuar dhe e financon.
- 2. Zbatimi i detyrimit të pikës III.1 të këtij vendimi, duhet të realizohet brenda **muajit mars të vitit 2021**.
- 3. IAL private, duhet të informojnë AK, për zbatimin e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar në pikën III.2.

### IV. T'i rekomandojë INSTAT:

- 1. Të mbledhë të dhëna për arsimin e lartë dhe të mundësojë ofrimin e informacionit krahasues për cilësinë e IAL për çdo vit akademik, në mënyrë që të lehtësojë mundësitë e zgjedhjes së studentëve, për:
  - a. nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave; dhe
  - b. profileve të tyre në tregun vendas përkatës të punës.
- V. AK do t'i drejtohet MASR, në rast të mospërmbushjes së pikave II dhe III të këtij vendimi nga IAL, të cilat çënojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke kërkuar përmbushjen e tyre.
- VI. Mbylljen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë.
- VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga MASR, IAL publike dhe private dhe INSTAT, për një **periudhë 2 (dy)-vjeçare**.

### **Ky treg është në monitorim deri në 2022.**

- *Tregu i shërbimeve spitalore.*

AK ka realizuar procedurën e hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore, i cili përfshin shërbimin spitalor publik dhe jopublik.

Për të realizuar një vlerësim më të thelluar të tregut të shërbimeve spitalore, KK, me vendimin nr. 669, datë 24.12.2019 "Për vijimin e hetimit të hapur me VKK nr. 552, datë 04.10.2018, "Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar", ka kërkuar administrimin e të dhënave shtesë nga ofruesit e shërbimit dhe shtrirjen e analizës për një periudhë më afatgjatë.


Procedura hetimore ka përfunduar dhe pritet vendimmarrja e KK.

## PJESA E TRETË

### AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESEVE GJYQËSORE

AK i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktiv në të gjitha këto procese në shkallët e gjyqimit, nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga KK.

Ndjekja e çështjeve gjyqësore lidhet me ndikimin që kanë vendimet e KK në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë, si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e komisionit për marrje masash ndaj ndërmarrjeve, i janë nënshtruar procesit të ankimit në gjykatë.



#### Çështje të gjykuara

### 3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përgjatë vitit 2020 janë shqyrtuar 3 çështje:

1. Çështja gjyqësore me paditës: shoqëria “Electral” SHPK, të paditur AK me objekt: “Detyrimin e AK për nisjen e procedurave të hetimit paraprak dhe hetimit të thelluar ndaj subjektit Baboon.al për abuzim me pozitën dominuese”. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë rrëzoi kërkesë padinë e shoqërisë “Electral” SH.P.K
2. Çështja gjyqësore me paditës: “Durrës Container Terminal” SHA, të paditur AK me objekt shfuqizimin e paragrafit “I” dhe “II” të vendimit të KK nr. 696, datë 11.06.2020 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SH.A për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë rrëzoi kërkesë padinë e shoqërisë tregtare “Durrës Container Terminal” SHA.
3. Çështja gjyqësore me paditës: Federata Shqiptare e Futbollit, të paditur AK me objekt shfuqizimin e vendimit të KK nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me

pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë rrëzoi kërkesë padinë. FSHF ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë përgjatë vitit 2020 nuk është shqyrtuar asnjë çështje me objekt vendimet e KK.



## **PJESA E KATËRT**

### **ROLI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURENCËS**

#### **4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2020 ka vlerësuar:

##### **3 (tre) projektligje:**

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar””, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara;
- Projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili përcakton rregullat për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- Projektligji “Për prokurimin publik”, i cili përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore, në lidhje me kontratat publike dhe konkurset e projektimit.

##### **4 (katër) projekt-akte normative:**

- Projekt-vendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj”, i cili synon rritjen e eficiencës dhe qëndrueshmërisë së prokurimit publik, përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me koncesionet dhe partneritetin publik-privat, riorganizimin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe shqyrtimin e ankesave;
- Projekt-urdhër “Për riaktivizimin e Komitetit Ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”, i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e veprimtarive të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike;
- Projekt-rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për shfrytëzimin e multipleksit” e cila ka për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe Ofruesi Shërbimi Mediatik Audioviziv, lidhur me shfrytëzimin e multipleksit, rrjetit numerik;
- Projekt-rregullore “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH” e cila ka për objekt dhe qëllim, përcaktimin e rregullave dhe procedurave për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH nga ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar, për transmetime audio dhe/ose audiovizive tokësore.

## 2 (dy) projekt-akte të tjera:

- Projekt Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i cili përmban një plan pune 3-vjeçar, ku për çdo objekt strategjik janë përcaktuar proceset përkatëse, të zbërthyer në fushën e veprimit, veprimtarisë me përparësi dhe rezultatet e pritshme;
- Projekt propozimi “Projekti Hidroenergjetik i Devollit-Alternativa Optimizimi”, kërkuar nga MIE, i cili ka të bëjë me zgjerimin e projektit hidroenergjetik në zonën e Devollit, me qëllim optimizimin e alternativave.


## 24 (njëzetë e katër) projekt-akte normative në tregun e energjisë:

ERE, gjatë vitit 2020, ka dërguar për opinion pranë AK, projekt-aktet normative në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.


## 4 (katër) projekt-akte normative në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave:

ERRU, gjatë vitit 2020, ka sjellë për opinion pranë AK, projekt-aktet normative mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjetllës Kanalizime Roskovec SHA; Pogradec SHA; Peqin SHA; Fier SHA.


### 4.2 Advokacia e Konkurrencës




Nismat e advokacisë sipas llojit: vitet 2006-2019



*Advokacia e konkurrencës: sipas publikut të synuar*



*Advokacia e konkurrencës sipas sektorëve: vitet 2006-2019*



*Advokacia e konkurrencës sipas sektorëve dhe llojeve të nismave: vitet 2006-2019*

Gjatë vitit 2020, në funksion të advokacisë, AK ka realizuar si më poshtë:

1. Në kuadër të projektit të BERZH “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, është hartuar dokumenti “*Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit*”, miratuar me VKK nr. 757, datë 23.12.2020 “Miratimi i dokumentit – “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”.

Dokumenti “*Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit*”, synon:

- Promovimin e një mjedisi konkurrues, duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha institucionet shtetërore si dhe nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të publikut dhe komunitetit të biznesit, lidhur me përftimet që sjell një konkurrencë e lirë dhe efektive në treg.
- Përmirësimin e përpjekjeve të institucionit lidhur me advokacinë e konkurrencës përkundrejt të gjithë aktorëve në treg, si konsumatorët, komuniteti i biznesit, institucionet shtetërore etj.
- Rritjen e efikasitetit të punës advokuese të AK, duke përforcuar, nga njëra anë, rolin advokues të institucionit dhe nga ana tjetër, strategjinë e komunikimit, në drejtim të një grupi të larmishëm të palëve të synuara të interesit.

Dokumenti “*Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit*”, ka identifikuar disa fusha kryesore ku duhet vepruar, ku secila ka një objektiv të gjerë dhe përfshin të paktën një veprimtari të rekomanduar:

- Lidhur me fushën “*Forcimi i Rolit Advokues të Autoritetit të Konkurrencës*”, rëndësi duhet t’i kushtohet përmirësimit të kulturës së konkurrencës në vend, rritjes së ndërgjegjësimit të palëve kryesore të interesit mbi përftimet e konkurrencës, ndërveprimet të intensifikuara me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, marrëdhëniet dhe bashkëpunimet me institucionet shtetërore dhe entet rregullatore, planifikimit të

hollësishëm të aktiviteteve të advokacisë brenda institucionit, monitorimit dhe vlerësimit *ex-post* të veprimtarive të advokacisë etj.;

- Lidhur me fushën “*Forcimi i Strategjisë së Komunikimit të Autoritetit të Konkurrencës*” rëndësi duhet t’i kushtohet mjeteve dhe përmbajtjes që duhet të ketë komunikimi, të shfrytëzohen kanalet e duhura të komunikimit, monitorimi i efikasitetit të strategjisë së komunikimit etj..
2. Hartimi i “Dokumentit - “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”,” u parapri nga një numër aktivitete. AK, në bashkëpunim me Lear (subjekti përfitues i projektit të BERZH, për AK), kanë organizuar takime dhe intervista online me entet rregullatore: AKEP, AMA, AMF, ERE, ERRU, BSH, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj., me aktorë të ndryshëm në treg, që i përkasin komunitetit të biznesit, si dhe institucione të arsimit të lartë.
  3. Në kuadrin e advokacisë së konkurrencës, në kushtet e pandemisë COVID-19, AK ka realizuar në **datën 5 dhjetor 2020** në “**Ditën ndërkombëtare të konkurrencës**” video-projeksionin me titull “**Promovim publik i ligjit të konkurrencës**” nëpërmjet video-projeksionit në godinën e UT.
  4. Bashkëpunimi me institucionet publike/ memorandum mirëkuptimi:
    - Në datë 29 dhjetor 2020 u nënshkrua **Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, duke synuar ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e rëndësishme që ligjet organike kanë parashikuar për funksionimin e AK dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të nxitur transparencën dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë në treg, mbrojtjen e të dhënave personale, si një model për shoqërinë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave themelore të njeriut.

## **PJESA E PESTË**

### **INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

#### **5.1 Kontributi në kuadrin e Integritimit Evropian**

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2020-2022, AK ka përmbushur 100% procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës, konkretisht:

- KK, me vendimin nr. 697, datë 30.06.2020, ka miratuar udhëzuesin “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”. Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën (EU) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve Anëtare për të qenë më efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm” (32019L0001).
- KK, me vendimin nr. 683, datë 18.03.2020, ka miratuar udhëzuesin “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”. Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën e Komisionit 2002/77/EC të datës 16 shtator 2002 “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike” (320032L0077).

Përveç këtyre dy akteve të parashikuara në PKIE 2020-2022, me synim plotësimin e kuadrit ligjor dytësor në fushën e konkurrencës, janë përafruar dhe janë miratuar edhe dy akte nënligjore të tjera:

- KK, me vendimin nr. 694, datë 15.05.2020, ka miratuar udhëzuesin “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje”. Ky udhëzues ka përfaruar rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1/2003 të datës 16 dhjetor 2002 “Për implementimin e rregullave të konkurrencës të parashikuara në nenet 81 dhe 82 të TFEU”, si dhe Njoftimin e Komisionit “Mbi rregullat e aksesit në dosjen e Komisionit për rastet sipas neneve 81 dhe 82 të TFEU, nenet 53, 54 dhe 57 të marrëveshjes së EEA dhe Rregullores së Këshillit (EC) nr. 139/2004”;
- KK, me vendimin nr. 678, datë 13.02.2020, ka miratuar udhëzuesin “Për praktikatat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003”. Ky udhëzues ka përfaruar Njoftimin e Komisionit “Mbi praktikatat më të mira për sjelljet sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU / (2011/C 308/06)”.

#### **5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

Gjatë veprimtarisë së vitit 2020, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjërë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, në datë 23 nëntor 2020 u nënshkrua **Memorandumi i Bashkëpunimit** ndërmjet Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Autoritetit Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën, për të promovuar bashkëpunimin në fushën e politikës së konkurrencës dhe zbatimin e ligjit të konkurrencës, duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe, bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.

Në kuadër të Projektit të BE, **IPA Twinning** “*Forcimi kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*”, midis Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Komisionit Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën (CNMC), u zhvilluan një sërë aktivitetesh nga të cilat, gjysma e tyre u zhvilluan online nëpërmjet platformës Moodle, si rrjedhojë e pandemisë të COVID-19.

Tematikat e aktiviteteve të zhvilluara, të ndara sipas komponentëve janë:

- Komponenti 1: Përafrimi i kuadrit ligjor me legjislacionin evropian, referuar këtij komponenti janë zhvilluar 7 aktivitete;
- Komponenti 2: Forcimi i kapaciteteve administrative të AK, referuar këtij komponenti janë zhvilluar 9 aktivitete;
- Komponenti 3: Roli i AK për të bashkëpunuar me palë të ndryshme interesi, referuar këtij komponenti janë zhvilluar 5 aktivitete.

Në kuadër të Projektit të **BERZH** “*Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia*” janë realizuar trajnime dhe vizita studimore, të cilat për shkak të pandemisë të COVID-19, janë zhvilluar online.

Tematikat e trajnimeve të zhvilluara, të ndara sipas komponentëve janë:

- Komponenti 1: Janë zhvilluar 4 trajnime referuar analizës së përqendrimeve dhe hetimeve të përgjithshme;
- Komponenti 2: Janë zhvilluar 6 trajnime referuar programit ekonometrik STATA;
- Komponenti 3: Janë zhvilluar 2 trajnime referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë;
- Komponenti 4: Hartimi i Strategjisë për advokacinë e konkurrencës, e cila u miratua me vendimin e KK nr.757, datë 16.12.2020 “Mbi miratimin e Strategjisë së Advokacisë të Konkurrencës.

Stafi i AK është trajnuar në kuadër të bashkëpunimit me **OECD-GVH/RCC**, si më poshtë vijon:

- Në datat 18-20 shkurt 2020 u zhvillua seminari me temë “Zbatimi i ligjit të konkurrencës dhe advokacia në sektorin bankar dhe atë të sigurimeve”, Budapest, Hungari;
- Në datat 1-2 korrik 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua seminari virtual me temë “Si i përgjigjet politika e konkurrencës krizës”;
- Në datat 22-24 shtator 2020 për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua seminari virtual me temë “Parimet dhe procedurat e ligjit të konkurrencës- Stafi i ri”;

- Në datat 15-16 dhjetor 2020 për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua seminari virtual me temë “Politika e konkurrencës për të siguruar një nivel të barabartë loje ndërmjet kompanive private dhe publike”.

#### **Aktivitetet e tjera nga OECD, UNCTAD etj:**

- Në datën 25 shkurt 2020, nga OECD u zhvillua seminari me temë “Dita e Hapur e Konkurrencës” në Paris, Francë;
- Në datën 26 shkurt 2020, nga OECD u zhvillua seminari me temë “Marrëveshjet Vertikale dhe Kufizimet” në Paris, Francë;
- Në datën 3 qershor 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua virtualisht nga UNCTAD konferenca me temë: “Çështje të konkurrencës, roli i bashkëpunimit ndërkombëtar në kohën e COVID-19”;
- Në datën 9 nëntor 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua nga BERZH seminari virtual me temë “Politika e konkurrencës në kohën e COVID-19”;
- Në datat 7-10 dhjetor 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua virtualisht nga OECD Forumi i 19 Global i Konkurrencës, ku AK paraqiti kontributin në sesionin “Market studies to tackle emerging competition issues”;
- Në datat 15-16 dhjetor 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua virtualisht nga UNCTAD në bashkëpunim me Autoritetin Turk të Konkurrencës, Forumi Vjetor i Stambollit;
- Në datën 17 dhjetor 2020, për shkak të pandemisë të COVID-19, u zhvillua nga FAS Rusia seminari virtual “Çështje të konkurrencës në tregjet farmaceutike dhe mjeteve mjekësore gjatë pandemisë”.




## PJESA E GJASHTË

### ORGANIZIMI I AUTORITETIT

#### 6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës

Për vitin 2020, AK në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr.9121/2003, ka pasur si objektiv strategjik të tij, për t'u afruar sa më shumë me modelin institucional të institucioneve homologe të vendeve të BE.

Struktura e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 128/2018 “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës” ka synuar kryesisht në shtimin e numrit të punonjësve në drejtoritë teknike, për të mbuluar aktivitetin në rritje, për të gjitha tregjet në territorin e RSH, me qëllim plotësimin e nevojave të konsumatorit shqiptar, nëpërmjet një konkurrence të lirë dhe efektive si në tregjet prodhuese dhe ato të shërbimit. Rritja e numrit të punonjësve, do të sigurojë që analizat, studimet, inspektimet dhe gjithë procedurat hetimore të kryhen më shpejt.




#### 6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2020

Gjatë vitit 2020, përdorimi i buxhetit të miratuar për AK ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara si dhe nëpërmjet forumeve të realizuara me biznesin në rrethe, ka realizuar një prezantim të njohjes me ligjin, për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Buxheti është realizuar në masën 94%, i ndarë në zërat sipas aneksit bashkëlidhur këtij raporti.

Në grafikun e mëposhtëm, pasqyrohet në % çdo kategori shpenzimesh, përkundërt totalit të realizuar të buxhetit:



### 6.3 Të ardhurat e realizuara

Gjatë këtij viti, në buxhetin e shtetit është derdhur si e ardhur nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi) deri më 31 dhjetor 2020 shuma 12,410,000 lekë.

Tabela e shpenzimeve të AK për vitin 2020


Kodi	Emërtimi	Plani ( me ndryshime)	Fakti	/
		Lekë		
600	Paga , shpërblime etj	52,800.000	50,036.238	95%
601	Kontribute për Sigurime Shoqërore	9,200.000	7,876.457	87%
602	Materiale dhe Shërbime	12,260.000	11.831.985	97%
606	Ndhimja ekonomike	440.000	431.800	98%
231	Investime	1,000.000	95.000	96%
<b>Totali</b>		<b>75.700.000</b>	<b>71,130.480</b>	<b>94%</b>

### Të ardhurat të realizuara nga përqendrimet të derdhura në buxhet për vitin 2020

Kodi	Emërtimi	Fakti
		Lekë
711	Të ardhura të derdhura në buxhet (njoftim dhe autorizim përqendrimi)	12,410,000




## 6.4 Rekrutimet

Gjatë vitit 2020, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive teknike janë realizuar 9 procedura rekrutimi me lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe duke pasur në konsideratë sistemin e karrierës në shërbimin civil. Qëllimi në këto procedura ka qenë dhe do të mbetet pranimi i stafit me integritet profesional dhe eficient.



Gjatë vitit 2020, janë realizuar 10 trajnime jashtë vëndit, dhe 12 brenda vëndit, ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm i punonjësve të institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojn të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me ICN, RCC, OECD dhe brenda vëndit, nga Shkolla e Administratës Publike, kryesisht lidhur me HRMIS-in dhe për hedhjen e pagesave në sistemin e përgjithshëm financiar, prokurimet publike, sistemet online dhe programet IPA.

Nëpërmjet projekteve të BERZH dhe IPA është trajnuar i gjithë stafi i AK sipas sektorëve përkatës.



## PJESA E SHTATË

### PRIORITETET E AK PËR VITIN 2021

#### 7.1 Prioritetet e AK për vitin 2021.

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si:

- tregu i telekomunikacioneve;
- tregu i energjisë;
- tregu i hidrokarbureve;
- tregu financiar;
- tregu i sigurimeve;
- tregu farmaceutik (barna dhe pajisje mjekësore);
- tregu i produkteve paramjekësore (maska, alkool, xhel disinfektant, termometër);
- tregu spitalor;
- tregu i prokurimeve publike.

Gjatë vitit 2021, si prioritete të AK, në linjë edhe me ato të vendeve anëtare të BE, do të jenë monitorimi dhe hetimi në sektorë/tregje të reja:

- sektori i ekonomisë dixhitale;
- tregu i mediave audiovizive;
- tregu i shërbimeve portuale.

Në fokus të AK gjatë vitit 2021 do të jetë edhe **mbrojtja e të dhënave personale dhe konkurrenca**, si një çështje më rëndësi të veçantë në axhendën e autoriteteve homologe të konkurrencës në BE, si dhe atë të DG Competition.

#### 7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE.

Gjatë vitit 2021, AK do të bëjë të mundur:

1. **Implementimin e udhëzuesit** “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, në zbatim të Direktivës (EU) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 – (ECN+), dhe **konkretisht: propozimin e amendimeve ligjore** në ligjin nr. 9121/2003, në kuadër të Projektit IPA Twinning “*Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*”.
2. **Implementimin e dokumentit** “*Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit*”, që do të ketë në fokus:
  - a. rritjen e efektshmërisë së advokacisë së konkurrencës, në të cilën përfshihen objektiva specifike me një publik të synuar;

- b. rritjen e eficiencës së strategjisë së komunikimit me institucionet publike, entet rregullatore dhe të gjithë aktorët e interesuar, dhe të përfshirë në fushën e konkurrencës.
3. **Rritjen e numrit të stafit teknik** me 4 (katër) inspektorë, për të monitoruar, hetuar dhe për të bërë analiza në tregje dhe sektorë të ekonomisë shqiptare, që janë në rritje dhe të larmishme. Kjo kërkesë, buron jo vetëm nga nevojat e AK si një institucion i cili mbulon të gjithë territorin e RSH, por ajo mbështetet edhe në kërkesat e vazhdueshme të Progres Raporteve të KE për Shqipërinë, ku konkretisht, edhe në Progres Raportin e fundit, është kërkuar shtimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të AK, si një institucion i cili ka rolin e tij si lider dhe koordinator në Kapitullin 8, të MSA “Politikat e konkurrencës”.
4. **Forcimin e kapaciteteve administrative**, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.
5. **Adresimin** në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive (trajtimi i ankesave), si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me entet rregullatore.
6. **Zbatimin e PKIE (2021-2023)** dhe detyrat që rrjedhin nga MSA, si lider i kapitullit të 8 “Politika e Konkurrencës” dhe konkretisht, transpozimin në legjislacionin e brendshëm të:
- a. Dokumentit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e dokumentacionit ekonomik dhe mbledhjes së të dhënave si në rastet e zbatimit të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 edhe në rastet e përqendrimeve” (përafuar me aktin e BE: Praktikrat më të mira të DG Competition për dorëzimin e dokumenteve ekonomike dhe mbledhjes së të dhënave në rastet e zbatimit të neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe në rastet e përqendrimeve);
- b. Dokumentit “Mbi praktikrat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve” (përafuar me aktin e BE: Praktikrat më të mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të përqendrimeve të KE).

**ANEKSE**  
**VENDIMET E AK 2020**

1. Vendim nr.673, datë 23.01.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.”.
2. Vendim nr.674, datë 23.01.2020 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Roskovec” SHA”.
3. Vendim nr.675, datë 07.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”.
4. Vendim nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”.
5. Vendim nr. 677, datë 13.02.2020 “Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”.
6. Vendim nr.678, datë 13.02.2020 “Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar””.
7. Vendim nr.679, datë 14.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.
8. Vendim nr.680, datë 14.02.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.
9. Vendim nr.681, datë 05.03.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”.
10. Vendim nr.682, datë 05.03.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Dasof doo. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft mbH.”.
11. Vendim nr. 683, datë 18.03.2020 “Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike””.
12. Vendim nr.684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
13. Vendim nr.685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
14. Vendim nr.686, datë 06.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 5% të aksioneve të shoqërisë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga shoqëria Banka Credins SHA”.
15. Vendim nr.687, datë 06.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft”.
16. Vendim nr.688, datë 06.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës”.
17. Vendim nr.689, datë 24.04.2020 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”.
18. Vendim nr.690, datë 28.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.”.
19. Vendim nr.691, datë 06.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Unione di Banche Italiane S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”.
20. Vendim nr.692, datë 06.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Air Liquide CZ, s.r.o dhe Air Liquide Slovakia, s.r.o nga shoqëritë Messer Technogas s.r.o dhe Messer Tatragas, spol.s.r.”.
21. Vendim nr.693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”.
22. Vendim nr.694, datë 15.05.2020 “Mbi miratimin e udhëzuesit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje””.
23. Vendim nr.695, datë 15.05.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Joint-Venture nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes)”.

24. Vendim nr.696, datë 11.06.2020 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”.
25. Vendim nr. 697, datë 30.06.2020 “Mbi miratimin e udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”.
26. Vendim nr.698, datë 20.07.2020 “Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqytjes Financiare në lidhje me licencimin e Postës Shqiptare për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”.
27. Vendim nr.699, datë 20.07.2020 “Për disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqytjes Financiare në lidhje me licencimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime”.
28. Vendim nr.700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve, dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”.
29. Vendim nr.701, datë 30.07.2020 “Për mos klasifikimin si përqendrim, të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk”.
30. Vendim nr.702, datë 30.07.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”.
31. Vendim nr.703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelcom”.
32. Vendim nr.704, datë 10.09.2020 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Pogradec” SHA”.
33. Vendim nr.705, datë 10.09.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.”.
34. Vendim nr.706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”.
35. Vendim nr.707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”.
36. Vendim nr.708, datë 23.09.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”.
37. Vendim nr.709, datë 23.09.2020 “Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të kuotave të shoqërisë Tranzit SHPK nga shoqëria “NCH Balkan Fund, L.P” dhe “New Century Holdings XI, L.P” tek z.Andi Ballta”.
38. Vendim nr.710, datë 08.10.2020 “Për dhënien e disa rekomandimeve, Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Peqin” SHA”.
39. Vendim nr. 711, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN”.
40. Vendim nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”.
41. Vendim nr. 713, datë 15.10.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Opel Automotive S d.o.o. nga shoqëria Euroimpex d.o.o.”.
42. Vendim nr. 714, datë 15.10.2020 “Për mos klasifikimin si përqendrim të transaksionit, lidhur me ndryshimin e strukturës së tërthortë të pronësisë së shoqërisë One Telecommunications SHA”.
43. Vendim nr.715, datë 15.10.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “MEGAPHARMA” SHPK në tregun e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore”.
44. Vendim nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma & AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch & Farma” SHPK, “IMI & Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK,

- “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi & Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial & ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.”.
45. Vendim nr.717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Delta Pharma & AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “IMI & Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi & Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial & ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
  46. Vendim nr. 718, datë 19.10.2020 “Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Komisionit të Konkurrencës.”.
  47. Vendim nr.719, datë 28.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”.
  48. Vendim nr.720, datë 12.11.2020 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Fier” SHA”.
  49. Vendim nr.721, datë 12.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softwerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car. SW Wolfsburg AG”.
  50. Vendim nr.722, datë 12.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.”.
  51. Vendim nr.723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffesen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo.”.
  52. Vendim nr.724, datë 19.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Hans Muller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Muller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.”.
  53. Vendim nr.725, datë 19.11.2020 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe xhel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
  54. Vendim nr.726, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “IMI – FARMA” SHPK”.
  55. Vendim nr. 727, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEDICAMENTA” SHPK”.
  56. Vendim nr.728, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MINI INVEST” SHPK”.
  57. Vendim nr.729, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MSE” SHPK”.
  58. Vendim nr.730, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “TRESI FARM” SHPK”.
  59. Vendim nr. 731, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DIAL-ALB” SHPK”.
  60. Vendim nr.732, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “LEKLI” SHPK”.
  61. Vendim nr.733, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “INTERMED” SHPK”.
  62. Vendim nr.734, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “SIROL 2008” SHPK”.
  63. Vendim nr.735, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “AQUILA GROUP” SHPK”.



64. Vendim nr.736, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “EVITA” SHPK”.
65. Vendim nr.737, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA MED” SHPK”.
66. Vendim nr. 738, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MONTAL” SHPK”.
67. Vendim nr.739, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “INCOMED” SHPK”.
68. Vendim nr.740, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “O.E.S DISTRIMED” SHPK”.
69. Vendim nr.741, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “PHARMAONE” SHPK”.
70. Vendim nr.742, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “ALFARMAKOS” SHPK”.
71. Vendim nr.743, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “TRIMED” SHPK”.
72. Vendim nr.744, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “MEGAPHARMA” SHPK”.
73. Vendim nr.745, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK”.
74. Vendim nr.746, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FLORIFARMA” SHPK”.
75. Vendim nr.747, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “CFO PHARMA” SHPK”.
76. Vendim nr.748, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “DELTA PHARMA - AL” SHPK”.
77. Vendim nr.749, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FUFARMA” SHA”.
78. Vendim nr.750, datë 26.11.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.”.
79. Vendim nr.751, datë 26.11.2020 “Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.
80. Vendim nr.752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe xhel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.
81. Vendim nr.753, datë 03.12.2020 “Për dhënien e disa rekomandimeve Agjencisë së Prokurimeve Publike mbi zbatimin e kuadrit ligjor”.
82. Vendim nr.754 datë 09.12.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore””.
83. Vendim nr.755, datë 09.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK nga Kastrati Group SHA”.
84. Vendim nr.756, datë 16.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Daimler Truck AG dhe shoqëria Aktiebolaget Volvo”.
85. Vendim nr.757, datë 16.12.2020 “Miratimi i dokumentit – “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”.
86. Vendim nr.758, datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”.
87. Vendim nr.759, datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”.

**ANEKSI**  
**ÇËSHITJE TË MBARTUARA PËR GJYKIM NË VITIN 2020**

Çështje të mbartuara për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit:

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ekma Albania” SHPK, i paditur AK me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “Ekma Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës”.
2. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ekma Albania” SHPK, i paditur AK me objekt: Shfuqizimi i vendimit të AK me nr. 542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës”. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi të pranojë kërkesë padinë duke shfuqizuar vendimin e AK.
3. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “SGS Automotive Albania” SHPK, i paditur AK me objekt: Shfuqizimin e vendimit nr. 562, datë 25.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Vodafone Albania”, i paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 i KK në lidhje me aplikimin e gjobës ndaj subjektit paditës në masën 3.011.173 lekë. Rregullimin e pasojave të ardhura nga paligjshmëria e akteve administrative, duke detyruar të paditurin t’i kthejë paditësit masën e gjobës së paguar”.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Telekom Albania”, i paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 i KK, me titull “Për vendosjen e gjobës ndaj ndërmarrjeve Telekom Albania sha dhe Vodafone Albania sha, për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga KK në vendimin nr. 475, datë 21.09.2017, vetëm për pjesën e aktit administrativ që i përket shoqërisë Telekom Albania sha”.
6. Çështja administrative me paditës AK, i paditur, ndërmarrja “Tirana-Lines” dhe palë e tretë Zyra Përmbartimore Tiranë, me objekt: Kundërshtim veprimesh përmbartimore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi pranimin e padisë së AK, duke detyruar Zyrën e Përmbartimit Tiranë që të vazhdojë me ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit.
7. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Armo” Sha, i paditur AK, me objekt: Kundërshtimin e vendimit të KK nr. 150, datë 20.07.2010 “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Armo” Sha, në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2441, datë 17.10.2012, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 5681, datë 28.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 150, datë 20.07.2010 të KK. Kundër këtij vendimi, AK paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. 1445, datë 04.07.2017 vendosi kthimin për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Çështje të mbartuara për gjykim nga kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë:

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “EMS APO”, i paditur AK, me objekt “Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr. 80-2017-3056, datë 10.07.2017 ku është vendosur: Rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit të AK.
2. Çështja administrative me: paditës ndërmarrjen “Hyundai” Shpk, i paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi të KK nr. 154, datë 01.10.2010 “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” Shpk, “Hyundai Auto Albania” Shpk, “Noti” Shpk dhe “Ultra Motors” Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre, për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 4553, datë 21.09.2015 ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke u shprehur në favor të Autoritetit të Konkurrencës.
3. Çështja administrative me kërkuës ndërmarrjen “EMS APO” person i tretë AK, me objekt: Pezullimi tërësisht i masave të përkohshme, të vendosura me vendimin e KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr. 80-2017-3056, datë 10.07.2017 ku është vendosur: Rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit të AK. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.
4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “AMC” Sha, i paditur AK, me objekt: Pavlefshmëria e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007 “Për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive Albanian Mobile Communication Sha dhe Vodafone Albania SHA”. Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me këtë çështje, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007. Kundër këtij vendimi pala paditëse “AMC” Sha, paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ‘AMC’ paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila pasi e shqyrtoi, vendosi kthimin për rigjykim të kësaj çështjeje pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo Gjykatë ka konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të KK. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Tirana Lines”, i paditur AK, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” Sha, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” Sha dhe “Parku Urban të Udhëtarëve” Shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit, në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës”. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 1547,

- datë 12.04.2017 vendosi rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e KK dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv.
6. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Tirana Urban Trans”, i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. 554, datë 17.03.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësi, ndërmarrja “Tirana Urban Trans” Sha, dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
  7. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “NAZERI” SHRSF & “DEA” SHRSF, i paditur AK, me objekt shfuqizimi i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Shpk, “Toni Security” Shpk, “Eurogjici Security 1” Shpk, “Nazëri – 2000” Shpk dhe “Dea Security” Shpk për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, në lidhje me këtë çështje shpalli: moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs i padituri, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
  8. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “AMC” Sha, i paditur: AK; me objekt anulim i vendimit të KK nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga AK, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Gjykata e Apelit, Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke pushuar gjykimin lidhur për vendimin e KK nr. 26, 02.10.2005 dhe duke pranuar padinë në lidhje me vendimin e KK nr. 27, 12.10.2005. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
  9. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen” Ultra-Motors”, i paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 154, datë 01.10.2010 "Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve "Classic" SHPK, "Hyundai Auto Albania" sh.pk, "Noti" sh.p.k dhe "Ultra Motors" Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre, për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja", lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Çështja ndodhet për shqyrtim në Dhomën e Këshillimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
  10. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ferlut”, i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 4991, datë 10.06.2015, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri,

AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.

11. Çështja administrative me paditës ndërmarrjet “Eurogjici Security” Shpk, "Eurogjici, Security 1" Shpk, "Toni Security" Shpk, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1400, datë 30.05.2016, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
12. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Alba Trans” Shpk, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit 290, datë 23.07.2013 të KK, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje, shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 2981, datë 11.07.2014, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur, AK. Është zhvilluar një proces gjyqësor në dhomë këshillimi nga kjo gjykatë ku është vendosur kalimi në seancë gjyqësore.

